

UNIVERSITETI I PRISHTINES “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI MASTER: MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULA



TEZA MASTER

**Lidhja mes presionit të bashkëmoshatarëve dhe suksesit
të nxënësve në shkollat fillore**

Mentori/ja:

Prof. Dr. Majlinda Gjellaj

Kandidati/ja:

Mimoza Rexha

Prishtinë, janar 2022

© [2022]-[Mimoza Rexha] Të gjitha të drejtat të rezervuara.

FAKULTETI I EDUKIMIT

Studimet Master

PROGRAMI: MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULA

TEZË MASTERI

E paraqitur nga: Mimoza Rexha

Me kërkim të gradës shkencore

Master

Mentore: Prof. Dr. Majlinda Gjelaj

Tema: “ Lidhja mes presionit të bashkëmoshatarëve dhe suksesit të nxënësve në shkollat
fillore”

Mbrohet para komisionit vlerësues të përbërë nga:

1. Prof. Dr.Majlinda Gjelaj, _____(mentore)
2. Prof. Dr. Ass. Vlora Sylaj, _____ (kryetare e komisionit)
3. Prof. Dr. Teuta Danuza _____ (anëtare e komisionit)

Prishtinë

2022

ABSTRAKT

Një ndër gjërat që na preokupon më së shumti për fëmijët është edhe sukcesi i tyre në shkollë, padyshim që në suksesin e tyre luajnë rol një numër i konsiderueshëm faktorësh dhe presioni mund të jetë njëri prej tyre.

Nga kjo lind edhe qëllimi i këtij hulumtimi që të kuptohet lidhshmëria ndërmjet presionit të bashkëmoshatarëve dhe suksesit të tyre në shkollë.

Metoda kërkimore e përdorur për këtë studim është sasiore. Ky studim është realizuar në dy shkolla të qytetit të Vushtrisë, të cilat u përzgjedhën me mostër të rastësishme. Pjesëmarrës në hulumtim ishin 130 nxënës të klasëve të pesta.

Instrumenti i cili është përdorur për mbledhjen e të dhënave është Pyetësori i Avantazheve dhe Vështirësive (SDQ) nga Robbert Goodman, 1997.

Të dhënat e grumbulluara u analizuan me programin SPSS (Statistical Package for the Social Sciences). Analizat e përdorura në këtë hulumtim janë: analiza deskriptive, e korrelacionit, T-test dhe Anova.

Rezultatet e këtij hulumtimi treguan se ka lidhshmëri ndërmjet presionit të bashkëmoshatarëve dhe suksesit të tyre në shkollë dhe tendenca është që sa më të mira të jenë marrëdhëniet mes bashkëmoshatarëve aq më të suksesshëm janë ata në shkollë. Po ashtu rezultatet treguan se ka lidhshmëri mes sjelljes prosociale dhe suksesit të nxënësve në shkollë. Nxënësit me sjellje prosociale tregojnë sukses më të mirë në shkollë.

Si përfundim mund të themi se marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve janë shumë të rëndësishme në zhvillimin e fëmijëve dhe në performancën akademike. Prandaj si prindërit ashtu edhe mësuesit duhet t'i kushtojnë rëndësi zgjedhjes së shoqërisë që bëjnë fëmijët, si dhe të inkurajojnë fëmijët për sjellje prosociale, sepse fëmijët me sjellje prosociale bashkëveprojnë me bashkëmoshatarët dhe të rriturit në mënyrë të suksesshme, e cila i ndihmon fëmijët në performancën e tyre akademike, si dhe fëmijët me sjellje prosociale menjanojnë presionin e bashkëmoshatarëve.

Fjalët kyçe: arritje akademike, bashkëmoshatarë, nxënës, presion, sjellje prosociale.

ABSTRAKT

One of the things that worries us the most about children is their success at school, obviously a considerable number of factors play a role in their success and pressure can be one of them.

From this arose the purpose of this research to understand the relationship between peer pressure and their success in school.

The research method used for this study is quantitative. This study was conducted in two schools in the city of Vushtrri, which were selected by random sample. Participants in the research were 130 fifth graders.

The tool used for data collection is the Advantage and Difficulty Questionnaire (SDQ) by Robbert Goodman, 1997.

The collected data were analyzed with SPSS (Statistical Package for the Social Sciences) program. The analyzes used in this research are: descriptive analysis, correlation analysis, T-test and Anova

The collected data were analyzed with SPSS (Statistical Package for the Social Sciences) program. The analyzes used in this research are: descriptive analysis, correlation analysis, T-test and Anova.

The results of this research showed that there is a correlation between peer pressure and their success in school and the tendency is that the better the relationships between peers the more successful they are in school. The results also showed that there is a correlation between prosocial behavior and student success in school. Students with prosocial behavior show better success in school.

In conclusion we can say that peer relationships are very important in children's development and in academic performance. Therefore, both parents and teachers should pay attention to the choice of society that children make, as well as encourage children to prosocial behavior, because children with prosocial behavior interact successfully with peers and adults, which helps children in their academic performance as well as children with prosocial behaviors avoid peer pressure

Keywords: academic achievement, peers, students, pressure, prosocial behavior.

FALËNDERIMI

Në këtë studim kanë kontribuar shumë persona. Prandaj për tërë këtë rrugëtim do të falënderoja ata që me ndihmën e tyre arrita këtu.

Falënderoj Universitetin e Prishtinës dhe stafin e profesorëve të Fakultetit të Edukimit të cilët më angazhimin dhe përkushtimin e tyre arritem në finalizimin e gjithë procesit me rezultate jashtëzakonisht të kënaqshme. Ju jam mirënjohëse!

Një falënderim i veçantë shkon për mentoren, Prof. ass. dr. Majlinda Gjelaj, e cila nuk kurseu kohën e saj për të më ndihmuar dhe motivuar gjatë gjithë këtij procesi të punës sime, falënderoj gjithashtu anëtarët e komisionit!

Nuk mund të lë pa falënderuar edhe gjithë pjesëmarrësit në hulumtim, pa pjesëmarrjen e të cilëve nuk do të kishte mundësi të realizohej një punë e tillë.

Si dhe falënderoj familjen dhe shoqërinë time për mbështetjen e dhënë në vazhdimësi.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	iii
ABSTRAKT	iv
FALËNDERIMI	v
Lista e tabelave	ix
Lista e figurave	x
I. HYRJE.....	1
II. SHQYRTIMI I LITERATURËS	4
II.1 Marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve.....	4
II.1.1 Vështirësitë në marrëdhëniet me bashkëmoshatarët	6
II.1.2 Teoritë për marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve.....	7
II.2 Socializimi dhe sjellja prosociale	8
II. 3 Çrregullimi i sjelljes tek fëmijët	9
II.4 Presioni	10
II.4.1 Presioni pozitiv	12
II.4.2 Presioni negativ.....	13
II.5 Presioni i bashkëmoshatarëve dhe performanca e tyre në shkollë	15
II.6 Presioni dhe mbikqyrja e prindërve në arritjet akademike të fëmijëve	16
III. Definimi i problemit, formulimi i qëllimit, pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza/t.....	17
III.1 Definimi i problemit.....	17
III.2 Qëllimi i hulumtimit.....	17
III.3 Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat.....	17
III.3.1 Pyetjet kërkimore të këtij hulumtimi janë	17
III.3.2 Hipotezat të cilat priten të vërtetohen janë	18
IV. METODOLOGJIA	19
IV.1 Dizajni i hulumtimit.....	19

IV.2 Pjesëmarrësit	19
IV.3 Instrumentet	20
IV.4 Analizat e të dhënave	20
IV. 4.1 Analiza deskriptive- Descriptive Statistics.....	21
IV.4.2 Besueshmëria e instrumentit	22
IV.5 Aspekti etik	22
V. REZULTATET E HULUMTIMIT	23
V.1 Karakteristikat kryesore të pjesëmarrësve në studim	23
V.2 Analiza përshkruese për konstruktet e SDQ-së	24
V.2.1 Analiza përshkruese për problemet emocionale të nxënësve	25
V.2.2 Analiza përshkruese për problemet në sjellje të nxënësve	30
V.2.3 Analiza përshkruese për shkallën e hiperaktiviteti te nxënësit	35
V.2.4 Analiza përshkruese për shkallën e problemeve të bashkëmoshatarëve	40
V.2.5 Analiza përshkruese për sjelljen prosociale të nxënësve	45
V.3 Gjetjet kryesore të hulumtimit.....	50
VI. DISKUTIME DHE KONKLUDIMET.....	62
VI.1 Limitet/ kufizimet në hulumtim	64
VI.2 Implikimet praktike nga studimi	65
VII. PËRFUNDIME	66
LITERATURA	67
SHTOJCA.....	72
SHTOJCA 1. Pyetësi demografik dhe pyetësi i Avantazheve dhe Vështirësive	72

LISTA E SHKURTESAVE

ADHD - Attention Deficit Hyperactivity Disorder

DKA - Drejtoria Komunale e Arsimit

SDQ - Strengths and Difficulties Questionnaire

SPSS - Statistical Package for the Social Sciences

Lista e tabelave

<i>Tabela 1. Të dhënat përshkruese për gjininë dhe vendbanimin e pjesëmarrësve</i>	21
<i>Tabela 2. Analiza e besueshmërisë së pyetësorit SDQ-së.....</i>	22
<i>Tabela 3. Analiza përshkruese për suksesin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe, matematikës dhe njeriu dhe natyra.</i>	23
<i>Tabela 4. Suksesi i përgjithshëm i nxënësve.</i>	24
<i>Tabela 5. Klasifikimi i konstrukteve dhe niveli i shfaqjes së tyre tek fëmijët të shprehura me mesatare.</i>	50
<i>Tabela 6. Analiza e T-test mes konstrukteve (problemet emocionale, probleme me sjelljen, hiperaktiviteti, probleme me bashkëmohatarët dhe sjellja prosociale) dhe gjinisë.....</i>	52
<i>Tabela 7. Analiza e Korrelacionit në mes konstrukteve të SDQ-së me suksesin e përgjithshëm të nxënësve.</i>	53
<i>Tabela 8. Analiza e Anoves mes konstruktit “Probleme me bashkëmohatarët” dhe “Suksesit të nxënësve”.</i>	55
<i>Tabela 9. Analiza e Anoves mes konstruktit të “Sjelljes prosociale” dhe “Suksesit të nxënësve”.</i>	57

Lista e figurave

<i>Figura 1. Kam shumë dhimbje koke, barku apo më vjen të vjellë.</i>	25
<i>Figura 2. Merakosem shumë.</i>	26
<i>Figura 3. Shpesh jam i pakënaqur, zemërthyer apo gati për të qarë.</i>	27
<i>Figura 4. Ndihem nervoz në situata të reja, e humbas lehtë vetëbesimin.</i>	28
<i>Figura 5. Frikësohem shumë, trembem lehtë.</i>	29
<i>Figura 6. Zakonisht bëj si më thonë.</i>	30
<i>Figura 7. Përlahem shumë, mund t'i detyroj të tjerët të bëjnë çfarë dua unë.</i>	31
<i>Figura 8. Shpesh më akuzojnë për gënjeshtar dhe mashtrues.</i>	32
<i>Figura 9. Marr në shtëpi, shkollë ose diku tjetër gjëra që nuk janë të miat.</i>	33
<i>Figura 10. Bëhem shumë nervoz dhe shpesh e humb gjakftohtësinë.</i>	34
<i>Figura 11. Jam i padurueshëm, nuk mund të qëndroj gjatë në një vend.</i>	35
<i>Figura 12. Vazhdimisht jam nervoz dhe i lëvizshëm.</i>	36
<i>Figura 13. Lehtë hutohem, e kam të vështirë të përqendrohem.</i>	37
<i>Figura 14. Mendohem para se t'i bëj gjërat.</i>	38
<i>Figura 15. E mbaroj (e çoj deri në fund) një punë që e nisi.</i>	39
<i>Figura 16. Zakonisht rri vetëm, luaj vetëm apo mbyllem në vetvete.</i>	40
<i>Figura 17. Kam një apo më shumë shokë të ngushtë.</i>	41
<i>Figura 18. Moshatarëve të mi zakonisht iu pëlqej.</i>	42
<i>Figura 19. Fëmijët dhe të rinjtë e tjerë kapen me mua dhe më ngacmojnë.</i>	43
<i>Figura 20. Kaloj më mirë me të rriturit se sa me moshatarët e mi.</i>	44
<i>Figura 21. Përpiqem të sillem mirë me njerëzit, respektoj ndjenjat e tyre.</i>	45
<i>Figura 22. Zakonisht i ndaj gjërat me të tjerët (ushqimin, lojrat, lapsat, etj.).</i>	46
<i>Figura 23. Ndihej nëse dikush lëndohet, shqetësohet apo ndihet i sëmurë.</i>	47
<i>Figura 24. Sillem mirë me fëmijët më të vegjël.</i>	48
<i>Figura 25. Shpesh ndihmoj vullnetarisht të tjerët (prindërit, mësuesit, fëmijët).</i>	49
<i>Figura 26. Problemet me bashkëmoshatarët dhe suksesi i përgjithshëm i nxënësve.</i>	56
<i>Figura 27. Sjellja prosociale dhe suksesi i përgjithshëm i nxënësve.</i>	58
<i>Figura 28. Problemet emocionale dhe suksesi i përgjithshëm i nxënësve.</i>	59
<i>Figura 29. Probleme me sjelljen dhe suksesi i përgjithshëm i nxënësve.</i>	60
<i>Figura 30. Hiperaktiviteti dhe suksesi i përgjithshëm i nxënësve.</i>	61

I. HYRJJE

Evoluimi i shoqërisë njerëzore solli pas vetës ndryshime të mëdha shoqërore. Avancimi i pozitës shoqërore të fëmijëve, garantimi i të drejtave elementare si me akte te brendshme shtetërore ashtu edhe me akte ndërkombëtare, vijueshmëria në institucione arsimore dhe socializimi i tyre solli në pah një mozaik personalitetesh të fëmijëve, duke u nisur nga ata më ambiciozët e deri tek ata më të ndrojturit që shpeshherë gjendjen e tyre psikologjike e manifestojnë me një pasiguri dhe frikë ndaj faktorëve të ndryshëm social (Pappas, 2017). Me inkuadrimin e tyre në institucione arsimore, ndër të tjera, ata i nënshtrohen shumë faktorëve, që në të shumtën e rasteve mund të jenë vendimtar në zhvillimin intelektual të tyre. Faktori ndaj të cilit sot fëmijët dhe adoleshentët janë të ekspozuar pothuajse shumicën e kohës është presioni i cili vjen pikërisht nga bashkëmoshatarët e tyre (Davis, 2014).

Grup njerëzish që janë të së njëjtës moshë ose status shoqëror, si shokët tuaj të klasës, quhen bashkëmoshatarë. Kur ata përpiqen të ndikojnë në mënyrën se si vepron për t'ju shtyrë të bëni diçka quhet presion i bashkëmoshatarëve (Lyness, 2015).

Pra, presioni si fenomen paraqet ndikim të drejtpërdrejt tek individët nga kolegët ose efekti mbi një individ i cili inkurajohet të ndjek kolegët e tij duke ndryshuar qëndrimet, vlerat dhe sjelljet e tyre në përputhje me ato të grupit (Treynor, 2009).

Sipas studiuesit Laurence Steinberg dhe kolegëve të tij bashkëmoshatarët shpeshherë bashkohen në grupazhe si mënyrë e shoqërimit, të cilat vijnë si rezultat i sjelljeve dhe qëndrimeve të përbashkëta të tyre (Woolfolk, 2011).

Tema, lidhja e presionit të bashkëmoshatarëve me arritjet akademike merr një rëndësi më të madhe në një shoqëri të mbushur me njerëz, ku arsimi është një pasuri dhe dëshira për të lënë mënjanë të tjerët dhe për të përparuar është e madhe.

Duke pasur parasysh mënyrën se si bashkëmoshatarët ndikojnë tek nxënësit, Steinberg i sistematizon ata në dy grupe: bashkëmoshatarët me ndikim pozitiv dhe ata me ndikim negativ. Sipas tij, në grupin e parë bëjnë pjesë bashkëmoshatarët të cilët ndikojnë në arritje të suksesit, ndërsa në grupin e dytë bashkëmoshatarët të cilët ndikojnë në sjelljet problematike (AACAP, 2019).

Bazuar në një studim që zgjati 3 vjet dhe që analizoi 20000 nxënës në nëntë shkolla të mesme në Wisconsin dhe California, Steinbergu konstatoi se bashkëmoshatarët ofrojnë nxitje për disa veprime dhe tallje për disa të tjera, çka bën që të shkaktohet presion tek individ.

Varësisht se si presioni ndikon tek individ, studimet e fundit na hedhin në pah dy lloje të reagimit ndaj presionit. Grupi i parë i individëve fenomenin e presionit e konsiderojnë si shtytës drejt suksesit, këta fëmijë në rast se i ekspozohen presionit kjo i bën ata që të mendojnë, të ndërmarin veprime që ta dëshmojnë veten dhe presionin e bërë ta shikojnë në prizmin pozitiv, përderisa grupi i dytë karakterizohet me zhgënjim, ndërmarrje të veprimeve me qëllim që t'iu pëlqejnë të tjerëve pa marr parasysh pasojat, duke humbur kështu besimin në vetvete (AACAP, 2019).

Bazuar në një studim të bërë nga Dr.Eleni Andreou, arrihet në një konkluzion që fëmijët të cilët ushtrojnë presion tek fëmijët e tjerë, në të shumtën e rasteve janë vetë të ekspozuar ndaj këtij fenomeni, pra janë edhe shkaktar të presionit por edhe viktimë e tij nga dikush tjetër (Andreou, 2010).

Bazuar në hulumtime, vijmë në një konkluzion se shqetësimet më të mëdha të prindërve për fëmijët e tyre kishin të bënin pikërisht me çështjen e ngacmimeve dhe presioneve që fëmijët kishin nga bashkëmoshatarët e tyre. Presioni dhe ngacmimet janë ende të zakonshme dhe si i tillë është karakteristikë për fëmijët nga mosha shtatë dhe tetë vjeç, mirëpo kërkimet e fundit kanë vërtetuar se edhe nxënësit e klasëve të pestë, gjashtë dhe shtatë kanë përjetuar ose kanë qenë pjesë e ngacmimeve dhe presionit nga bashkëmoshatarët e tyre, gjë që ka ndikuar që fëmijët të kenë performancë të dobët në zhvillimin e tyre akademik (Coulson, 2015).

Nga disa vrojttime të bëra dhe format e tjera të kontaktit me nxënës dhe mësimdhënës ka dalë se një prej shkaqeve të humbjes së interesimit për mësim është presioni nga nxënësit problematik në shkollë (Statovci-Shala, 2014).

Prandaj është e rëndësishme të mësojnë si mësimdhënësit ashtu edhe nxënësit se si të trajtojnë presionin, i cili është i shfaqur nga një moshë e re duke shikuar të rriturit rreth nesh. Ne me anë të vëzhgimit identifikojmë se çfarë është një reagim i pranueshëm ndaj presionit dhe çfarë nuk është. Në këtë kuptim, prindërit dhe mësuesit janë modele të

roleve jo vetëm për rëndësinë e arsimit, por edhe për të trajtuar atë presion (Akhtar, 2011).

Meqenëse suksezi i nxënësve është një nga shqetësimet e prindërve dhe mësuesve, atëherë e konsideroj si temë mjaft të duhur për të parë ndikimin që paraqet presioni pikërisht në suksesin e nxënësve edhe në vendin tonë.

II. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Në procesin arsimor mësimdhënësit ballafaqohen me personalitete të ndryshme të fëmijëve, ku secili prej tyre ka karakteristika të veçanta, bazuar në karakteristikat e personave vihen në pah lloje të ndryshme të personaliteteve, ku disa prej tyre shpeshherë manifestojnë në personalitetin e tyre ndrojtje, pasiguri, mosbesim, frikë etj.

Pra, studimet tregojnë se këta fëmijë i nënshtrohen faktorëve të ndryshme, të cilët shpeshherë janë vendimtar në arritjet akademike të fëmijëve, e një ndër këta faktor është presioni.

Presioni konsiderohet si veprim negativ atëherë kur dikush me qëllim shkakton ose përpiqet të shkaktojë një lëndim ose parehati tek një person tjetër (Shala, 2013).

Si prind, po ashtu edhe si mësimdhënës është e rëndësishme që të krijohet një hapësirë e shëndetshme që fëmijët të lulëzojnë dhe të shkëlqejnë në jetë. Është e rëndësishme që të identifikohen pikat e forta të fëmijës dhe t'i japen udhëzimet e duhura se si t'i zhvilloj talentet e tij/saj. Nuk është e nevojshme që secili fëmijë të arrijë përsosmërinë akademike. Suksesi është i pashmangshëm nëse fëmijët kanë mbështetjen e kërkuar për të ndjekur ëndrrat e tyre në cilëndo fushë që ata duan, pa ngjallur tek ata frikën e dështimit (Nair, 2019).

Duke ditur se si adoleshentët dhe fëmijët ndërveprojnë me bashkëmoshatarët e tyre, si bashkëveprojnë me njëri-tjetrin dhe se si prania e grupit të bashkëmoshatarëve ndikon në arritjet akademike të nxënësve në shkollë, kjo temë luan një rol të rëndësishëm për kategori të ndryshme, madje edhe për të gjithë sistemin arsimor (Leka, 2015).

II.1 Marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve

Një bashkëmoshatar është një person i cili është i barabartë me një tjetër, ka të njëjtën pozitë dhe i përket një grupi të caktuar shoqëror, duke ndarë karakteristika të përafërta me këtë grup (Powell, 2007).

Pra, me fjalën bashkëmoshatar kuptojmë një grup shoqëror, në të cilin bëhen pjesë e grupit fëmijët me interes të ngjashëm, grupmoshë të njëjtë dhe përafërsisht mendime të njëjta (Deepika & Prema, 2017)

Ndërsa grupi i bashkëmoshatarëve është një burim dashurie, simpatie dhe mirëkuptimi, vendi në të cilin fëmijët e gjejnë veten si dhe një burim në të cilin fëmijët gjejnë përgjigjen në pyetjen "Kush jam unë?" (Powell, 2007).

Grupi i bashkëmoshatarëve është grupi i parë shoqëror jashtë shtëpisë në të cilin një fëmijë përpiqet të fitojë pranimin dhe njohjen (Falade, 2021).

Bashkëmoshatarët janë një ndër grupet parësore të fëmijëve, prandaj kanë një rol jetik në arritjet akademike të tyre. Pra, bashkëmoshatar mund të jetë kushdo që ka përafërsisht të njëjtin mendim, të njëjtën sjellje dhe barazi me moshën ose aftësinë (Hardcastel, 2002).

Bashkëmoshatarët ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë në arritjet akademike të fëmijëve (Falade, 2021).

Një bashkëmoshatar mund t'i bëjë presion fëmijëve të tjerë në mënyrë të drejtpërdrejt duke u kërkuar atyre të bëjnë diçka, ose mund t'i ngacmojnë ashtu që ata të bien në përputhje me sjelljen e bashkëmoshatarëve. Po ashtu ata të cilët bëjnë presion mund të mos thonë asgjë ose të mos veprojnë asgjë, por në vend të kësaj ata mund t'i bëjnë presion atyre duke i trajtuar si të dëbuar ose duke i injoruar nga grupi shoqëror (Johnson, 2000).

Grupi i bashkëmoshatarëve është një ndikim i rëndësishëm gjatë gjithë jetës, por ato janë më kritike gjatë viteve të zhvillimit të fëmijërisë dhe adoleshencës, pasi në këtë kohë socializimi është një faktor i rëndësishëm për nxënësit (Falade, 2021).

Gjatë viteve shkollore nxënësit krijojnë lidhje dhe marrëdhënie më të ngushta me miqtë dhe bashkëmoshatarët e tyre. Marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve ofrojnë një mbështetje emocionale për fëmijët, si dhe kanë një ndikim të madh në sjelljen, qëndrimet dhe njohuritë e tyre (Maunder & Monks, 2015).

Ndikimi i bashkëmoshatarëve mund të ndodhë në tri nivele. Në nivelin e parë përfshihen fëmijët të cilët i bashkohen grupit të bashkëmoshatarëve dhe refuzojnë të ndryshojnë besimet personale, por një presion i vogël nga bashkëmoshatarët mund të ndihmojë që fëmija të ndryshojë. Në nivelin e dytë ndikimi i bashkëmoshatarëve është kur fëmijët sillen si bashkëmoshatarët e tyre. Ndryshojnë stilin e tyre dhe miratojnë rregullat e grupit, mirëpo ata mund të kthehen në besimet e tyre origjinale kur presioni i bashkëmoshatarëve largohet. Niveli i tretë është ndikimi i bashkëmoshatarëve që ndryshon fëmijët

përgjithmonë. Kjo është faza kryesore sepse mund të ndërtohet ose të shkatërrohet e ardhmja e tij për shkak të këtij ndikimi apo presioni (Akhtar & Aziz, 2011).

Sipas Ryan (2015), ndikimet e grupit të bashkëmoshatarëve janë më të theksuara dhe vërehen më shumë në institucionet më të larta arsimore sesa në shkollën e mesme të ulët dhe fillore.

Presioni i bashkëmoshatarëve shihet shpesh gjatë fazës së adoleshencës, sepse adoleshentët shumë herë gjejnë mbështetje dhe ngushëllim midis bashkëmoshatarëve të tyre dhe synojnë të bëjnë atë që bëjnë bashkëmoshatarët e tyre pa qenë të vetëdijshëm nëse është e mirë apo e keqe për ta. Adoleshenca është një periudhë e një individi që është kalimtare, kur një fëmijë arrin pikën e ndryshimit të fëmijërisë në moshë madhore. Ndërsa fëmijët rriten dhe arrijnë adoleshencën, adoleshentët bëhen më të varur nga bashkëmoshatarët.

Mjedisi shoqëror i adoleshencës mund të ndikojë tek adoleshentët, sepse kryesisht në këtë periudhë adoleshentët priren të komunikojnë më shumë me bashkëmoshatarët e tyre sesa me familjen, e veçanërisht në marrjen e zgjedhjeve dhe rritjen e vlerave të tyre morale në jetë (Moldes, Biton, Gonzaga & Moneva, 2019).

II.1.1 Vështirësitë në marrëdhëniet me bashkëmoshatarët

Sipas studimeve, nga 5% deri në 10% e fëmijëve përjetojnë vështirësi në marrëdhëniet me bashkëmoshatarët, si refuzimi dhe ngacmimi nga bashkëmoshatarët.

Hulumtuesit tregojnë se vështirësitë në marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve, veçanërisht refuzimi nga bashkëmoshatarët sjellin probleme të mëdha tek fëmijët si ankthin dhe depresionin. Po ashtu fëmijët e refuzuar nga bashkëmoshatarët e tyre ndiejnë një shkallë të lartë të vetmisë dhe shmangie sociale. Nga ana tjetër, hulumtuesit e tjerë kanë treguar se refuzimi i bashkëmoshatarëve rrit rrezikun për problemet e jashtme duke përfshirë sjelljet agresive, delikate dhe kundërshtuese (Shin, Cho, Shin & Park, 2016).

Hulumtimet kanë krahasuar fëmijët që kanë marrëdhënie të mira me bashkëmoshatarët me ata të cilët nuk kanë marrëdhënie të mira dhe refuzohen nga bashkëmoshatarët e tyre. Këto hulumtime tregojnë se refuzimi i bashkëmoshatarëve shkakton ndryshime në

arritjet e tyre akademike të cilët kanë sukses të dobët në shkollë e disa prej tyre braktisin shkollën (Gale, 2008).

Marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve ndikojnë në gjendjen emocionale si dhe në sjelljet e fëmijëve.

Fëmijët me marrëdhënie të mira me bashkëmoshatarët janë më të shëndetshëm dhe përshtaten me bashkëmoshatarët, ndërsa fëmijët të cilët nuk kanë marrëdhënie të mira me bashkëmoshatarët kanë probleme emocionale si dhe probleme në sjellje.

Hulumtimet tregojnë se mungesa e socializimit, agresiviteti si dhe hiperaktiviteti krijojnë probleme në marrëdhëniet me bashkëmoshatarët (Shin, Cho, Shin & Park ,2016).

II.1.2 Teoritë për marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve

Një perspektivë e hershme teorike mbi marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve rrjedh nga shkrimet e Piaget (1932), i cili sugjeroi që marrëdhëniet e fëmijëve me bashkëmoshatarët mund të dalloheshin qartë nga marrëdhëniet e tyre me të rriturit. Fëmijët respektojnë rregullat e të rriturve, jo domosdoshmërisht sepse i kuptojnë ato, por më tepër për shkak se kërkohet bindja. Në të kundërtën, marrëdhëniet e fëmijëve me bashkëmoshatarët u portretizuan si të balancuara, të barabarta, në një plan më shumë ose më pak horizontal të pohimit dhe dominimit të pushtetit. Piaget besonte se fëmijët mund të përjetonin mundësi për të eksploruar ide dhe shpjegime kundërthënëse, për të negociuar dhe diskutuar për perspektiva të shumta me bashkëmoshatarët.

Sipas teorisë së Sullivan (1953), konceptet e respektit, barazisë dhe reciprocitetit u zhvilluan nga marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve.

Ndërsa Cooley (1902) dhe George Herbert Mead (1934) ofroi një teori të tretë, në të cilën ai sugjeroi që aftësia për të reflektuar mbi vetveten zhvillohet gradualisht gjatë viteve të para të jetës, si një funksion i bashkëveprimit të bashkëmoshatarëve.

Teoria e të mësuarit dhe teoria e të mësuarit social është një çështje që ka udhëhequr kërkimet mbi marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve të fëmijëve. Parimi themelor i të mësuarit social është se fëmijet mësojnë për botërat e tyre shoqërore, si të sillen brenda këtyre konteksteve, nëpërmjet mbështetjes së drejtëpërdrejt të kolegëve dhe vëzhgimit të bashkëmoshatarëve kur ata janë duke vepruar.

Nga kjo perspektivë, bashkëmoshatarët shihen si kontrollues të sjelljes dhe agjent të ndryshimit të sjelljes për njëri-tjetrin. Në këtë drejtim, fëmijët ndëshkojnë ose injorojnë sjelljen shoqërore jonormative dhe shpërblejnë ose përforcojnë pozitivisht ato sjellje që konsiderohen si të përshtatshme dhe kompetente në aspektin kulturor. Kështu që nëse fëmijët sillen në një mënyrë shoqërore të përshtatshme, ata zhvillojnë marrëdhënie pozitive me kolegët e tyre, kurse kur fëmijët sillen në një mënyrë të papërshtatshme shoqërore, mund të rezultojë refuzimi i kolegëve.

Së fundi është teoria e socializimit e Harris (2009), e cila ka sfiduar pikëpamjen se prindërit kryesisht i krijojnë personalitetet e fëmijëve. Sipas mendimit të saj, grupi i bashkëmoshatarëve luan një rol më të rëndësishëm në personalitetin dhe zhvillimin shoqëror. Shkurtimisht, ajo propozoi që, pasi fëmijët të gjejnë veten jashtë shtëpisë, ata marrin normat që mbizotërojnë brenda grupeve shoqërore. Duke u nisur nga perspektivat psikologjike, sociale mbi rëndësinë e normave të grupeve, paragjykimet brenda grupit dhe armiqësitë jashtë grupit, ajo argumentoi se personaliteti i fëmijëve zhvillohet kryesisht nga përvojat e tyre brenda grupeve të kolegëve (Rubin, 2015).

II.2 Socializimi dhe sjellja prosociale

Zhvillimi njerëzor ndikohet nga shoqërizimi i tij me njerëzit e tjerë në mjedis. Socializimi si një proces i përhershëm nuk mund të kufizohet vetëm në anëtarët e familjes. Ndërsa një fëmijë rritet dhe piqet, bëhet më e nevojshme që trupat e jashtëm të përfshihen në jetën e tij/saj. Familja nuk pritet të sigurojë të gjithë arsimin e kërkuar nga fëmija në rritje. Shkolla është një institucion akademik i themeluar në të cilin synohet që sjellja e nxënësve të nxitet për t'i pajisur ata për shoqërizim profesional (Falade, 2021).

Pra, synohet që të formohen nxënës të cilët janë të prirur që në karakterin e tyre të shfaqin sjellje prosociale.

Sjelljet prosociale janë sjelljet të cilat kanë për qëllim të ndihmojnë të tjerët duke u shqetësuar për të drejtat, ndjenjat dhe mirëqënien e njerëzve të tjerë (Cherry, 2018). Sjellja prosociale është e lidhur me disa rezultate pozitive, duke përfshirë vetëvlerësim të

lartë, sukses akademik si dhe marrëdhënie të mira me të tjerët (Graaff, Carlo, Crocetti, Koot & Branje, 2017).

Fëmijët me sjellje prosociale bashkëveprojnë me bashkëmohatarët dhe të rriturit në një mënyrë të suksesshme dhe të përshtatshme. Sjelljet prosociale kategorizohen në tri grupe: ndarja (fëmijët ndajnë lodrat me njëri-tjetrin), ndihma (sillen mirë me të tjerët, ndihmojnë dhe shqetësohen për të tjerët) dhe bashkëpunimi (bashkëveprojnë me të tjerët për të arritur qëllimet e tyre) (Lay & Hoppmann, 2015).

Në sistemin shkollor, fëmija futet në grupin shoqëror të "mendjeve të ngjashme" dhe "interesit të ngjashëm". Si rezultat i qëndrimeve, aftësive të ndryshme, njohuritë fitohen përmes lojës me role (Ladd, 1990).

Grupi i bashkëmohatarëve është agjenti socializues më i rëndësishëm për fëmijën në zhvillim. Grupi i bashkëmohatarëve është strumbullari i ndryshimit shoqëror dhe gjatë bashkëveprimit me bashkëmohatarët jeta e fëmijës transformohet nga fëmija i pafuqishëm në një të rritur të pjekur (Bierman, 2004).

Fëmija që fiton mbështetje sociale nga bashkëmohatarët e tij apo saj është një faktor i rëndësishëm për të përballuar problemet dhe sëmundjet e ndryshme, të liruarit nga emocionet duke folur me dikë. Gjithashtu mbështetja sociale luan një rol të rëndësishëm për fëmijët, duke zvogëluar kështu efektet e stresit, situatat stresuese përmes mbështetjes së bashkëmohatarëve në grup (Esen & Gundogdu 2010).

II. 3 Çrregullimi i sjelljes tek fëmijët

Çrregullimi i sjelljes është një problem psikologjik i fëmijëve, që manifestohet me sjellje agresive, vjedhje, shkelje të rregullave si dhe me gënjeshtria. Ky sindrom psikologjik paraqitet në fëmijëri që përfshin fëmijët të cilët shfaqin sjellje agresive, nuk kanë shumë shokë dhe zhvillojnë një personalitet antisocial si dhe në adoleshencë që përfshinë personat të cilët kanë më shumë shoqëri, janë më pak agresiv por që do të jenë më antisocial kur të rriten (Nushi, 2018).

Çrregullimi i sjelljes është i lidhur me çrregullime të tjera psikologjike, siç janë: çrregullimi i vëmendjes/hiperaktivitetit (ADHD), depresioni dhe çrregullimet e të mësuarit.

Fëmijët me çrregullime të sjelljes shprehin sjellje agresive në formën e ngacmimit, agresionit fizik dhe sjelljes së egër ndaj bashkëmoshatarëve.

Lidhur me çrregullimet e sjelljes kategorizohen tre tipa:

-Tipi i grupit (është tipi më i përhapur), këta fëmijë grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të tyre, të cilët përshtaten me njëri-tjetrin dhe krijojnë besueshmëri ndërmjet vete, ndërsa me të tjerët shfaqin sjellje antisociale, zakonisht këta fëmijë kanë vështirësi në shkollë;

-Tipi i vetmuar agresiv, këta fëmijë shfaqin sjellje antisociale me familjen, janë jo empatik ndaj të tjerëve si dhe shfaqin dhunë fizike dhe verbale;

-Tipi i padiferencuar, që përfshihen fëmijët me tipare të përziera klinike.

Trajtimi i çrregullimeve në sjellje bëhet me një kombinim psikoterapish, në të cilën përfshihen ndryshimi i selljeve në shtëpi, në shkollë dhe në ambiente të ndryshme, pastaj trajnimi i prindërve për të ndryshuar mënyrën e ndërveprimit me fëmijët, trajnimi kognitiv duke vetëdijësuar fëmijët për sjelljet e gabuara dhe agresive si dhe mjekimi me medikamente (Hajdari, 2016).

II.4 Presioni

Presioni nënkupton dhënien e forcës çdo veprimtarie. Presioni i bashkëmoshatarëve do të thotë ndikimi i miqve mbi njëri-tjetrin dhe nxitja e ndryshimeve në mendjen dhe sjelljen emocionale nga njerëzit që i përkasin të njëjtit grup me interes të ngjashëm, moshë të njëjtë, prejardhje dhe status shoqëror (Nkpolu-Oroworukwo, 2021)

Presioni i bashkëmoshatarëve i referohet ndikimit të ushtruar nga një grup bashkëmoshatarësh në nxitjen e një personi për të ndryshuar qëndrimet dhe vlerat e tij/saj në përputhje me normat e grupit (Johnson, 2000).

Presioni luan një rol të madh tek bashkëmoshatarët në përcaktimin e personalitetit dhe mënyrën se si vishen, flasin dhe veprojnë.

Bashkëmoshatarët për t'u pranuar në grupin shoqëror shpesh ndryshojnë sjelljet dhe dëshirat e tyre, ndonjëherë veprojnë ndryshe dhe bëjnë gjëra të cilat nuk do të dëshironin t'i bënin vetëm për t'u ndjerë të pranuar dhe të respektuar nga bashkëmoshatarët e tyre (Padma 2014).

Prindërit dhe të rinjtë presionin e bashkëmoshatarëve e mendojnë si një shok i cili përdor fjalë inkurajimi, bindjeje ose kritikë për të bindur një tjetër. Për shembull: ”Provoje një cigare”, ”Nuk të bënë asgjë”. kjo formë e presionit njihet si presion aktiv. Ndërsa presioni pasiv është një formë tjetër e presionit të bashkëmoshatarëve e cila është më e rrezikshme. Kjo formë e presionit është shumë delikate që nuk përdor fjalë por që ndodh vetëm duke kaluar kohë me bashkëmoshatarët që sillen në mënyrë të caktuar. Në këtë mënyrë individi mund të ndikohet nga veprimet e tyre dhe të veproj me bashkëmoshatarët e tij duke i pranuar sjelljet e tyre si sjellje të mira (Kanhere, 2018).

Presioni mund të jetë me ndikim pozitiv si dhe me ndikim negativ. Është pozitiv nëse inkurajon qëndrim pozitiv, vlera të shëndetshme dhe respekt. Është negative nëse inkurajon qëndrim negativ. Presioni pozitiv forcon potencialin e një personi, çon drejt suksesit, ndërsa presioni negativ zvogëlon forcën e personit, çon në dështim në jetën akademike (Akhtar,2011).

Presioni si fenomen ndodh natyrshëm. Bashkëmoshatarët nuk zgjedhin të jenë nën presion apo nën ndikimin e dikujt tjetër, por mund të themi se zgjedhin se kush do të ushtroj presion ndaj tyre sepse janë ata të cilët zgjedhin shoqërinë dhe bëhen pjesë e një grupi të caktuar shoqëror.

Fëmijët e kanë të vështirë t’i rezistojnë presionit të bashkëmoshatarëve për arsye të ndryshme. Ata zakonisht përpiqen të jenë pjesë e një grupi bashkëmoshatarësh dhe mund të kenë frikë se do të refuzohen nga grupi. Ata nuk mund të kenë aq shumë vetëbesim si shumica e të rriturve dhe kështu mund të kenë frikë t’i bëjnë njerëzit të zemëruar (Seifert, 2012).

Prandaj është e rëndësishme që nxënësit të jenë të vetëdijshëm për presionin e bashkëmoshatarëve duke kuptuar gjërat e duhura dhe të gabuara. Prindërit duhet të kontrollojnë fëmijët e tyre, të dinë nëse fëmijët ngacmohen nga bashkëmoshatarët e tyre apo janë nën presionin e tyre, si dhe ti edukojnë fëmijët e tyre se duhet të mbrojnë të drejtat e tyre. Të mos bëjnë diçka për të cilën nuk ndjehen mirë vetëm pse bashkëmoshatarët e tyre kërkohen, të mos kenë frikë për tu thënë jo bashkëmoshatarëve për diçka që nuk duan, të bisedojnë me prindërit e tyre nëse janë nën presionin e bashkëmoshatarëve, të mos ndjekin bashkëmoshatarët e tyre në aktivitete të cilat janë të

dëmshme si dhe të zgjedhin shoqërinë e duhur, të shoqërohen me bashkëmoshatarët të cilët i bëjnë të ndjehen mirë (Khan, 2019).

II.4.1 Presioni pozitiv

Presioni i bashkëmoshatarëve nuk ka gjithmonë efekte negative. Në fakt, shumë herë fëmijët ndikohen pozitivisht nga bashkëmoshatarët e tyre.

Bashkëmoshatarët mund të kenë një ndikim pozitiv tek njëri-tjetri, për shembull, kur një nxënës në klasë shpjegon një mënyrë të lehtë për të zgjidhur një ekuacion matematikor, ose kur ndonjëri nga fëmijët mund të admiron një mik që është gjithmonë një nxënës i mirë dhe përpiqet të jetë si ai ose ajo, ose kur ndonjëri nga nxënësit i tërheq të tjerët për të lexuar librin e tij/saj të preferuar. Këta janë shembuj se si bashkëmoshatarët ndikojnë pozitivisht tek njëri-tjetri.

Sipas hulumtimeve presioni ndikon në motivimin e fëmijëve për të punuar më shumë drejt arritjes së qëllimeve të tyre, për të qenë pjesë në aktivitete të ndryshme si dhe për të përmirësuar performancën akademike. Efektet pozitive të presionit vërehen edhe tek nxënësit të cilët motivohen për të marrë nota të mira sepse shokët e tij po marrin nota të mira (Packer, 2014).

Kur një nxënës ndikohet dhe motivohet nga bashkëmoshatarët ai do të performojë shkëlqyeshëm në shkollë.

Duke marrë mbështetjen e nevojshme që vjen nga grupi i bashkëmoshatarëve, fëmija ka tendencë të shkëlqejë dhe të tejkalojë aftësinë e tij dhe të përqëndrohet më shumë në lidhje me studimet, të bëjë më të mirën në obligimet akademike në shkollë (Olalekan, 2016).

Ndërveprimi i fëmijëve me bashkëmoshatarët ndihmon në rritjen e aftësive dhe të performancës së tyre akademike në shkollë, sepse në këtë mënyrë ata mund të kërkojnë ndihmë nga bashkëmoshatarët e tyre dhe kjo u shërben si motivim, gjithashtu të mësuarit në bashkëpunim mund të jetë më produktiv sesa të të punuarit vetëm (Moldes, Biton, Gonzaga & Moneva, 2019).

Nëse fëmijët janë pjesë e një grupi të mirë, bashkëmoshatarët mund të luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e personalitetit. Bashkëmoshatarët mund të ndikojnë që fëmijët të ndryshojnë për përmirësim. Presioni i bashkëmoshatarëve mund t'i çojë në zgjedhjen e duhur në jetë (Painer, 2015).

II.4.2 Presioni negativ

Presioni i bashkëmoshatarëve nganjëherë mund të bëhet problem shumë i madh për fëmijët. Nganjëherë presioni i bashkëmoshatarëve mund të jetë pozitiv, por shumicën e rasteve është negativ.

Presioni i bashkëmoshatarëve përhap shprehi jo të mira për fëmijët, siç janë konsumimi i alkoolit, drogës dhe pirja e duhanit. Fëmijët shumë lehtë adaptohen me këto sjellje edhe pse e dinë se janë veprime të gabuara, arsyetohen se ndjehen të motivuar nga nevoja për t'u ndjerë të pranuar në grupin e bashkëmoshatarëve (Packer, 2014).

Ndonjëherë, ndikimi i grupeve të bashkëmoshatarëve mund të çojë në sjellje agresive.

Aspekti negativ i cili mund të jetë i dëmshëm për punën shoqërore dhe akademike të nxënësve janë rastet e sjelljes në grup, si mungesa e vazhdueshme në shkollë, vjedhja, mosbindja, përtacia, mosrespektimi i rregullave dhe rregulloreve të shkollës, e të tjera (Falade, 2021).

Presioni i grupit të bashkëmoshatarëve, përkatësisht anëtarëve të tij mund t'i detyroj të tjerët për të bërë gjëra të padëshiruara ose sjellje negative me praninë e një drejtuesi të veçantë të grupit të bashkëmoshatarëve, që ndryshe mund të konsiderohet si “lider” i grupit, i cili detyron anëtarët e grupit të tij për të bërë veprime devijuese ose promovon gjëra të padëshirueshme në grup (Dumas, Ellis, & Wolfe, 2012)

Fëmijët të cilët janë vazhdimisht nën presion qoftë të prindërve apo të bashkëmoshatarëve kanë gjasa më të larta të vuajnë nga sëmundje mendore. Stresi i lartë dhe i vazhdueshëm gjithashtu mund t'i vendos fëmijët në një rrezik më të madh për të zhvilluar depresion ose gjendje të tjera të shëndetit mendor.

Gjithashtu fëmijët të cilët përjetojnë presion kanë më shumë gjasa që të rrisin mundësitë e mashtrimit, mashtrimi është i zakonshëm në mesin e fëmijëve që ndiejnë presion për të performuar mirë.

Kur fëmijët mendojnë se qëllimi është që gjithmonë të "jenë më të mirët", ata ndihen në presion dhe ka mundësi të mos marrin pjesë kur nuk ka gjasa të shkëlqejnë. Pra, presioni ndikon në neglizhencë të aktiviteteve të ndryshme (Lockhart, 2020).

Presioni i bashkëmoshatarëve ndikon tek fëmijët në rënien e vetëbesimit. Fëmijët të cilët dikur ishin të sigurt në veten e tyre, presioni i bashkëmoshatarëve ka bërë që këta fëmijë të kenë vetëbesim të ulët dhe nuk ndjehen të sigurt për veten. Gjithashtu presioni ndikon edhe në vetëvlerësim të ulët, fëmijët kryesisht i shikojnë prindërit ose bashkëmoshatarët e tyre për të vërtetuar gjithçka që bëjnë, por nëse kritikohen në mënyrë të vazhdueshme nga ana tjetër, ka shumë të ngjarë që ata të krijojnë një imazh negativ për veten e tyre (Nair, 2019).

Kështu, janë bashkëmoshatarët e tyre të cilët ndikojnë tek ata qoftë në mënyrë pozitive apo negative.

Duke ditur efektet negative të presionit nga bashkëmoshatarët, atëherë lind pyetja: “Pse fëmijët i nënshtrohen presionit të bashkëmoshatarëve?”

Në bazë të hulumtimeve dhe psikologëve mund të arrihet në një përfundim se disa fëmijë i nënshtrohen presionit të bashkëmoshatarëve meqë duan të pëlqehen, të përshtaten me grupin sepse shqetësohen se fëmijët e tjerë mund të tallen me ta nëse nuk shkojnë së bashku me të tjerët e grupit. Të tjerët shkojnë përpara sepse janë kuriozë të provojnë diçka të re që të tjerët po bëjnë. Ideja se "të gjithë po e bëjnë këtë" mund të ndikojë që disa fëmijë të lënë gjykimin e tyre më të mirë, ose sensin e tyre të përbashkët prapa (Lyness, 2015).

II.5 Presioni i bashkëmoshatarëve dhe performanca e tyre në shkollë

Arritja akademike nënkupton arritjen e studentëve ose aftësia e tyre për të shkruar ose komunikuar me gojë saktësisht faktin ose përmbajtjen. Kjo gjithashtu reflekton atë se deri në çfarë mase sistemi arsimor i ka arritur qëllimet e tyre. Arritja akademike tregon shkallën në të cilën studentët kanë në zotërimin e një lënde (Deepika & Prema, 2017).

Zhvillimi i fëmijëve ndikohet shumë nga socializimi i tyre me fëmijët e tjerë në mjedis. Arritjet akademike të nxënësve supozohet të jenë në korrelacion me mbështetjen e dhënë nga prindërit, mësuesit dhe nga bashkëmoshatarët e tyre që ndikojnë në nivelin e tyre të performancës akademike (Moldes, Biton, Gonzaga & Moneva, 2019).

Bashkëmoshatarët ndikojnë në jetën e fëmijëve, vetëm duke kaluar kohë me njëri-tjetrin. Njëri mëson diçka të re nga tjetri dhe anasjelltas, është e natyrshme nga vet natyra njerëzore të dëgjosh dhe të mësosh nga njerëzit e tjerë në grupmoshën tënde (Lyness, 2015).

Në përgjithësi, presioni i bashkëmoshatarëve të nxënësve në shkollë ndikon në performancën akademike të studentëve për sa i përket përmbajtjeve të ndryshme (Moldes, Biton, Gonzaga & Moneva, 2019).

Bashkëmoshatarët ndihmojnë fëmijët në rritjen e aftësive të tyre si dhe në rritjen e performancës së tyre akademike në shkollë, shërbejnë si një motivim për fëmijët për të marrë nota të mira. Kur fëmijët marrin mbështetje nga bashkëmoshatarët e tyre përqendrohen më shumë në mësim dhe janë më të suksesshëm në shkollë (Reich, 2012).

Kjo varet nga grupi i bashkëmoshatarëve në të cilin është përfshirë nxënësi. Përfshirja e nxënësve në grupet e bashkëmoshatarëve problematik ndikon në humbjen e interesimit për mësim. Kjo manifestohet sidomos te një kategori nxënësish me qëndrime të luhatshme, pa një karakter të fortë dhe pa ndonjë mbikëqyrje të veçantë nga prindërit (Statovci-Shala, 2014).

II.6 Presioni dhe mbikqyrja e prindërve në arritjet akademike të fëmijëve

Shumë prindër duan t'i ndihmojnë fëmijët e tyre të bëhen më të mirët. Megjithatë, disa prindër vendosin pritshmëri të larta për fëmijët, gjë e cila i vë fëmijët nën një presion shumë të madh.

Një sondazh i vitit 2013 nga Qendra Kërkimore Pew zbuloi se 64% e amerikanëve thonë se prindërit nuk bëjnë presion të mjaftueshëm mbi fëmijët lidhur me arritjet e tyre akademike në shkollë. Fëmijët mund të kenë më pak gjasa të performojnë në maksimum nëse nuk marrin presion të mjaftueshëm nga prindërit e tyre.

Sidoqoftë, disa fëmijë mund të jenë nën presion të madh. Ndërsa në anën tjetër të rriturit gjithashtu kanë shprehur shqetësimet se fëmijët sot "nuk mund të jenë më fëmijë" sepse ata janë nën presion dhe pritet që ata të performojnë vazhdimisht mirë, duke lënë anash interesat dhe dëshirat e tyre, duke u munduar që të përmbushin kërkesat e prindërve (Lockhard, 2020).

Përsosmëria akademike ka qenë gjithmonë një simbol i krenarisë dhe statusit në shoqërinë tonë.

Prindërit natyrisht parashikojnë një të ardhme të ndritshme dhe të lumtur për fëmijët e tyre dhe njohuria se sa sfiduese është e ardhmja, i bën ata t'i shtyjnë fëmijët e tyre të jenë të mirë në çdo fushë. Sidoqoftë, presioni në rritje i prindërve mbi përsosmërinë akademike të fëmijëve është bërë një shqetësim i madh (Nair, 2019).

"Prindërit me presion të lartë" mund të këmbëngulin që fëmijët e tyre të performojnë vazhdimisht mirë në gara të ndryshme.

Prindërit kanë mendime dhe qasje të ndryshme për të inkurajuar fëmijët e tyre. Ndërsa pritjet e larta mund të jenë të shëndetshme, vendosja e presionit të vazhdueshëm mbi fëmijët mund të jetë e dëmshme. Fëmijët që mendojnë se janë nën presion të madh nga prindërit dhe të rriturit që çdoherë të shkëlqejnë mund të përjetojnë pasoja në fusha të shumta të jetës së tyre, duke u nisur nga shëndeti i tyre mendor (Lockhart, 2020).

III. Definimi i problemit, formulimi i qëllimit, pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza/t

III.1 Definimi i problemit

Një ndër çështjet që preokupon të gjithë prindërit, por edhe të tjerët janë arritjet akademike të fëmijëve, prandaj për të ndihmuar në këtë çështje është me rëndësi të njohim edhe faktorët të cilët ndërlidhen me arritjet akademike të fëmijëve në shkollë. Shumë hulumtime të bëra kanë treguar se presioni që shkaktojnë bashkëmoshatarët bënë që nxënësit të humbin interesimin për mësim dhe të kenë performancë të dobët në zhvillimin e tyre akademik.

Pra, problemi i këtij hulumtimi është efektet e presionit të bashkëmoshatarëve në suksesin e nxënësve.

III.2 Qëllimi i hulumtimit

Duke e parë rëndësinë e shoqërisë tek fëmijët në suksesin e tyre rrjedhë edhe qëllimi i realizimit të këtij hulumtimi, ku si qëllim kryesor është të shpjegohet lidhja ndërmjet presionit të bashkëmoshatarëve dhe arritjeve akademike të nxënësve të klasëve të pesta, të shkollave fillore në qytetin e Vushtrrisë.

III.3 Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat

III.3.1 Pyetjet kërkimore të këtij hulumtimi janë:

Cilat janë dallimet gjinore në shkallën e problemeve në sjellje?

Çfarë është dallimi gjinor në shkallën e sjelljes prosociale?

Si ndërlidhet sjellja prosociale me suksesin e nxënësve?

Si ndërlidhen marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve me arritjet akademike të nxënësve?

III.3.2 Hipotezat të cilat priten të vërtetohen janë:

H1: Djemtë kanë më shumë probleme në sjellje sesa vajzat – Hipotezë e diferencës

H2: Vajzat kanë nivel më të lartë të sjelljes prosociale sesa djemtë – Hipotezë e diferencës

H3: Nxënësit me sjellje prosociale kanë performancë më të lartë akademike- Hipotezë jo e diferencës

H4: Nxënësit të cilët kanë marrëdhënie të mira me bashkëmoshatarët kanë sukses më të lartë në shkollë – Hipotezë hulumtuese (e kërkimit, alternative).

IV. METODOLOGJIA

IV.1 Dizajni i hulumtimit

Ky projekt hulumtues, “Lidhja mes presionit të bashkëmoshatarëve dhe suksesit të nxënësve në shkollat fillore” është realizuar në qytetin e Vushtrrisë, përkatësisht në zonën urbane. Qasja metodologjike e përdorur në këtë studim është sasiore, duke përdorur pyetësin për mbledhjen e të dhënave dhe dizajni i këtij studim është i tipit korrelacional.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të kuptohet lidhshmëria ndërmjet presionit të bashkëmoshatarëve dhe suksesit të tyre në shkollë.

IV.2 Pjesëmarrësit

Popullacioni i këtij hulumtimi janë fëmijët e moshës 10-11 vjeç, përkatësisht nxënësit e klasëve të pesta, të qytetit të Vushtrrisë. Për një rezultat sa më të besueshëm për hulumtim nga gjithsej katër shkolla fillore që ka në qytetin e Vushtrrisë, me mostër të rastësishme janë përzgjedhur dy prej tyre. Shkollat që u përzgjedhën janë:

1. Shkolla fillore “ N.F”
2. Shkolla fillore “ A.Z.Ç”

Pjesëmarrës në këtë hulumtim do të jenë fëmijët e moshës 10-11 vjeçare, përkatësisht nxënësit e klasës së V-të të të dy shkollave. Shkolla fillore “N.F” ka gjithsej 112 nxënës të klasëve të pesta. Ndërsa shkolla fillore “A.Z.Ç” me gjithsej 104 nxënës të klasëve të pesta. Numri i nxënësve në total nga të dy shkollat është 216 nxënës.

Pra, duke pasur parasysh numrin e nxënësve në total, me nivel konfidence 95.0% dhe me shkallë të saktësisë 0.05%, mostra e cila do të përfshihet në këtë hulumtim do të jetë 130 nxënës, 65 nxënës nga shkolla “N.F” dhe 65 nxënës nga shkolla “A.Z.Ç”.

Duke pasur parasysh numrin e nxënësve në total (216) dhe numrin e mostrës që do të marrë pjesë në hulumtim (130), me mostër sistematike pyetësin do ta plotësoj çdo i dyti nxënës.

IV.3 Instrumentet

Përgatitja e instrumenteve për hulumtim në terren ka një rol shumë të rëndësishëm për realizimin e një hulumtimi të suksesshëm. Instrumenti që është përdorur në këtë hulumtim për grumbullimin e të dhënave dhe për të nxjerrë rezultate sa më të besueshme është instrumenti i pyetësorit.

Pyetësori i cili është përdorur përbëhet nga pyetësori demografik dhe pyetësori i Avantazheve dhe Vështirësive (SDQ) i hartuar nga Robert Goodman, 1997.

1. *Pyetësori demografik*, përmban pyetje të cilat mbledhin të dhënat demografike të pjesëmarrësve, si: vendbanimi, gjinia, mosha, suksesi në lëndë të veçanta dhe suksesi i përgjithshëm i nxënësve, e të tjera.
2. *Pyetësori i Avantazheve dhe Vështirësive (Strengths and Difficulties Questionnaire-SDQ)*, i hartuar nga Robert Goodman në vitin 1977. Ky pyetësor ka 25 pyetje dhe 5 kategori: problemet emocionale, problemet me sjellje, hiperaktiviteti, problemet me bashkëmoshatarët dhe sjellja prosociale. Pyetjet maten me shkallët e Likert: 1= jo e vërtetë; 2= pak e vërtetë dhe 3= shumë e vërtetë. Vlerësimi i këtij pyetësori është që sa më i lartë që është pikëzimi aq më shumë kanë probleme emocionale, pastaj probleme në sjellje, janë shumë hiperaktive, po ashtu pikëzimi i lartë na tregon se fëmijët kanë probleme më të mëdha me bashkëmoshatarët dhe janë më prosocial.

Me qëllim të matjes së besueshmërisë së instrumentit i cili është përdorur në hulumtim është bërë analiza e besueshmërisë. Në këtë aspekt, për matjen e besueshmërisë është përdorur koeficienti i Alfës së Kronbahut, i cili tregon vlerën α , ky koeficient tregon se instrumenti që është përdorur është i besueshëm apo jo.

IV.4 Analizat e të dhënave

Pjesë e këtij procesi ishte krijimi i databazës me të dhënat e grumbulluara, si dhe përpunimi dhe analiza e tyre.

Përpunimi dhe analiza e tyre u realizua nëpërmjet programit statistikor softuerik SPSS, duke përdorur analizat deskriptive dhe analizat statistikore. Në pjesën e parë të analizës do të fitojmë rezultate përshkruese, karakteristikat e pjesëmarrësve që kanë të bëjnë me gjininë, vendbanimin, suksesin e nxënësve në lëndë të veçanta dhe suksesin e

përgjithshëm të nxënësve, me qëllim që të kuptojmë nëse këto karakteristika lidhen me presionin e bashkëmoshtarëve, e me theks të veçantë me suksesin e tyre në shkollë.

Përveç statistikës përshkruese, në këtë studim janë përdorur analizat statistikore, si: korrelacioni që tregon se a ka lidhje mes marrëdhënieve të bashkëmoshtarëve dhe suksesit të tyre në shkollë si dhe a ka lidhje mes sjelljes prosociale dhe suksesit të nxënësve në shkollë, T-test që tregon nëse ka dallime gjinore sa i përket problemeve në sjellje dhe sjelljes prosociale. Anova për të treguar suksesin e nxënësve lidhur me konstruktet e pyetësorit.

Me anë të këtyre analizave statistikore analizuam dhe nxjerrëm rezultate duke u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore.

IV. 4.1 Analiza deskriptive- Descriptive Statistics

Tabela 1. Të dhënat përshkruese për gjininë dhe vendbanimin e pjesëmarrësve

		Numer	Perqindja
Gjinia	Mashkull	68	52.3
	Femer	62	47.7
Vendbanimi	Fshat	30	23.1
	Qytet	100	76.9

Në tabelë janë paraqitur të dhënat të cilat na tregojnë se në studim morën pjesë gjithsej 130 nxënës, 52.3% prej tyre janë meshkuj (N=68) dhe 47.7% femra (N=62). Në bazë të të dhënave rezulton se 23.1% e nxënësve ndodhen në zonën rurale (N=30) dhe 76.9% në zonën urbane (N=100).

IV.4.2 Besueshmëria e instrumentit

Për zhvillimin e hulumtimit është e rëndësishme edhe besueshmëria e pyetësit. Për të parë nëse ky pyetësor është i besueshëm u përdor analiza e vlefshmërisë së pyetësit përmes Alfës së Kronbahut, e cila gjithashtu është e bazuar në pyetjet e standardizuara.

Tabela 2. Analiza e besueshmërisë së pyetësit SDQ-së.

Analiza e besueshmërisë	
Cronbach's Alpha	Numri i pyetjeve
.723	38

Rezultatet tregojnë se besueshmëria e pyetësit për mbledhjen e të dhënave (SDQ) sipas Cronbach's Alpha=.723 është e kënaqshme, e pranueshme.

IV.5 Aspekti etik

Studimi është kryer duke marrë në konsiderat aspektin etik, për të marrë të dhëna sa më të sakta dhe duke zvogëluar sa më shumë mundësinë e rezultateve të pavërteta.

Për realizimin e këtij studimi është marrë leje nga DKA dhe zyrat arsimore përkatëse. Pas kësaj është kërkuar leje në drejtoritë e shkollave përkatëse për të lejuar zhvillimin dhe aplikimin e instrumentit dhe njëkohësisht u është kërkuar leje edhe nxënësve që morën pjesë në studim.

Çdo nxënësi iu shpjegua në mënyrë të qartë e të detajuar qëllimi i studimit. Gjithashtu, çdo subjekt u informua se ishte i lirë nëse ai donte të merrte pjesë ose jo në plotësimin e instrumentit. Pjesëmarrësve të përfshirë në studim iu pohua fakti se do të ruhej konfidencialiteti dhe plotësimi i pyetësit. Të dhënat e pjesëmarrësve të përfshirë në studim janë konfidenciale dhe se këto të dhëna do të përdoren vetëm për këtë studim, do të mbeten anonim.

Çdo paqartësi ose pakuptueshmëri e pyetësit nga ana e nxënësve ishte e pranueshme, iu jepnin sqarimet e duhura.

V. REZULTATET E HULUMTIMIT

Në këtë kapitull përshkruhen rezultatet e të dhënave të marra me aplikimin e pyetësorit. Të gjitha të dhënat kanë kaluar në fazën e pastrimit për të dhënë një saktësi sa më të madhe. Më poshtë përshkruhen rezultatet që janë marrë nga përpunimi i të dhënave të studimit.

V.1 Karakteristikat kryesore të pjesëmarrësve në studim

Tabela 3. Analiza përshkruese për suksesin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe, matematikës dhe njeriu dhe natyra.

		Suksesi në gjuhën shqipe	Suksesi në matematikë	Suksesi në njeriu dhe natyra
N	Valide	130	130	130
	Mungojnë	0	0	0
	Mesatarja	4.22	4.12	4.10
	Mediana	5.00	5.00	5.00
	Moda	5.00	5.00	5.00
	Minimumi	1.00	1.00	2.00
	Maksimum	5.00	5.00	5.00

Në këtë tabelë janë paraqitur statistika përshkruese për suksesin e nxënësve në shkollë në tri lëndë mësimore, në gjuhë shqipe, matematikë dhe në lëndën njeriu dhe natyra.

Fillimisht është paraqitur numri total i pjesëmarrësve në hulumtim (N=130), pastaj është paraqitur mesatarja, ku mesatarja më e lartë është në lëndën e gjuhës shqipe (M=4.22), pastaj në matematikë (M=4.12), ndërsa mesatarja më e ulët është treguar në lëndën njeriu dhe natyra (M=4.10). Ndërsa mediana e këtij vargu të të dhënave është 5. Moda në këtë varg është gjithashtu 5, minimum i vargut të të dhënave është 1, që kuptojmë që nota minimale është 1 (Min=1), ndërsa nota maksimale është 5, pra (Max=5).

Tabela 4. Suksessi i përgjithshëm i nxënësve.

Suksesi i përgjithshëm i nxënësve	N	%
Mjaftueshëm	5	3.8
Mirë	20	15.4
Shumë mire	32	24.6
Shkëlqyeshëm	73	56.2
Total	130	100.0

Nga tabela 4 kuptojmë se nga 130 nxënës (100%), 73 prej tyre kanë sukses të shkëlqyeshëm (56.2%), 32 prej tyre kanë sukses shumë mirë (24.6%), 20 të tjerë kanë sukses të mirë (15.4%) dhe vetëm 5 prej tyre kanë sukses të mjaftueshëm (3.8%).

V.2 Analiza përshkruese për konstruktet e SDQ-së

Përveç pyetësorit demografik është përdorur edhe pyetësi i Avantazheve dhe Vështirësive (SDQ). Ky pyetësor përbëhet nga 5 kategori ose konstrakte, të cilat janë: problemet emocionale, probleme me sjelljen, hiperaktiviteti, problemet me bashkëmoshatarët dhe sjellja prosociale. Secili konstrukt përbëhet nga 5 pyetje. Pra, gjithsej janë 25 pyetje.

Për të parë lidhshmërinë e presionit të bashkëmoshatarëve dhe suksesit të tyre në shkollë janë matur këto konstrakte tek nxënësit duke i ndërlidhur me arritjet akademike të tyre (suksesin e përgjithshëm të nxënësve).

Në vazhdim janë dhënë analiza përshkruese për secilin konstrukt, të cilat janë paraqitur në mënyrë grafike, të shprehura në përqindje.

V.2.1 Analiza përshkruese për problemet emocionale të nxënësve

Rezultatet e paraqitura me anë të grafikëve




Figura 1. Kam shumë dhimbje koke, barku apo më vjen të vjellë.

Lart shohim paraqitjen grafike për pyetjen e parë, të shprehura në përqindje.

Pra, në pyetjen e parë të konstruktit “Probleme emocionale” kuptojmë se nga 130 nxënës në total që ishin pjesë e hulumtimit, 68.46% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se nuk kanë problem shëndetësore (N=89), pra, janë përgjigjur me “Jo e vërtetë”, 21.54 % janë përgjigjur me “Pak e vërtetë” (N=28), ndërsa 10% kanë deklaruar se kanë dhimbje koke, barku ose u vjenë të vjellë, pra janë përgjigjur me “Shumë e vërtetë” (N=13).




Figura 2. Merakosem shumë.

Në deklaratën e dytë të këtij konstrukti “Merakosem shumë” kuptojmë se nga 130 pjesëmarrës, 16.92% janë përgjigjur me “Jo e vërtetë” (N=22), që do të thotë se nuk merakosen shumë, 46.15 janë përgjigjur me “Pak e vërtetë” (N=60), ndërsa 36.92% janë përgjigjur me “Shumë e vërtetë” (N=48).




Figura 3. Shpesh jam i pakënaqur, zemërthyer apo gati për të qarë.

Në deklaratën tjetër “Shpesh jam i pakënaqur, zemërthyer apo gati për të qarë”, 56.92% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë” (N=74), pastaj 33.85% kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë” (N=44), ndësa 9.23% kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë” (N=12).




Figura 4. Ndihem nervoz në situata të reja, e humbas lehtë vetëbesimin.

Në deklaratën “Ndihem nervoz në situata të reja. E humbas lehtë vetëbesimin” nga 130 pjesëmarrës në hulumtim, 65.38% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë” (N=85), ndërkohë që 21.54% prej tyre kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë” (N=28), ndërsa 13.08% e tyre kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë” (N=17).




Figura 5. Frikësohem shumë, trembem lehtë.

Në deklaratën “Frikësohem shumë, trembem lehtë” nga 130 pjesëmarrës në hulumtim 41.54% (N=54) janë përgjigjur me “Jo e vërtetë”, 38.46% (N=50) janë përgjergjigjur me “Pak e vërtetë”, ndërsa 20% (N=26) janë përgjigjur me “Shumë e vërtetë”.

V.2.2 Analiza përshkruese për problemet në sjellje të nxënësve

Rezultatet e paraqitura me anë të grafikëve




Figura 6. Zakonisht bëj si më thonë.

Pra, në deklaratën e parë të konstruktit “Probleme në sjellje” kuptojmë se nga 130 nxënës në total që ishin pjesë e hulumtimit, 23.85% (N=31) janë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, 40% (N=52) prej tyre kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa 36.15% (N=47) prej tyre kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.




Figura 7. Përlahem shumë, mund t'i detyroj të tjerët të bëjnë çfarë dua unë.

Në deklaratën “Përlahem shumë, mund t’i detyroj të tjerët të bëjnë çfarë dua unë”, nga 130 pjesëmarrës në hulumtim, 85.36% kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë” (N=111), pastaj 10% kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë” (N=13), ndërsa vetëm 4.62% kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë” (N=6).




Figura 8. Shpesh më akuzojnë për gënjeshtar dhe mashtrues.

Sa i përket deklaratës tjetër “Shpesh më akuzojnë për gënjeshtar/e dhe mashtrues/e” nga 130 pjesëmarrës 69.23% (N=90) kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, pastaj 20.77% (N=27) kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa vetëm 10% (N=13) kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.




Figura 9. Marr në shtëpi, shkollë ose diku tjetër gjëra që nuk janë të miat.

Ndërsa në deklaratën tjetër “Marr në shtëpi, shkollë apo diku tjetër gjëra që nuk janë të miat” nga 130 pjesëmarrës 92.31% (N=120) kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, pastaj në një përqindje shumë më të vogël 3.08% (N=4) kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa 4.62% (N=6) kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.



Figura 10. Bëhem shumë nervoz dhe shpesh e humb gjakftohtësinë.

Në deklaratën e fundit të këtij konstrukti “Bëhem shumë nervoz dhe shpesh e humb gjakftohtësinë”, nga 130 pjesëmarrës që ishin pjesë e hulumtimit 56.92% (N=74) janë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, 32.31% (N=42) prej tyre kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa 10.77% (N=14) prej tyre kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.

V.2.3 Analiza përshkruese për shkallën e hiperaktiviteti te nxënësit

Rezultatet e paraqitura me anë të grafikëve




Figura 11. Jam i padurueshëm, nuk mund të qëndroj gjatë në një vend.

Në deklaratën e parë të konstruktit të hiperaktivitetit: “Jam i padurueshëm, nuk mund të qëndroj gjatë në një vend”, nga 130 pjesëmarrës që ishin pjesë e hulumtimi 43.85% (N=57) janë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, po aq 43.85% (N=57) kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa 12.31% (N=16) prej tyre kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.




Figura 12. Vazhdimisht jam nervoz dhe i lëvizshëm.

Sa i përket deklaratës tjetër “Vazhdimisht jam nervoz dhe i lëvizshëm” nga 130 pjesëmarrës 48.46% (N=63) kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, pastaj 41.54% (N=54) kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa vetëm 10% (N=13) kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.




Figura 13. Lehtë hutohem, e kam të vështirë të përqendrohem.

Ndërsa në deklaratën tjetër “Lehtë hutohem, e kam të vështirë të përqendrohem” nga 130 pjesëmarrës 55.38% (N=72) kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, pastaj në një përqindje më të vogël 32.31% (N=42) kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa 12.31% (N=16) kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.




Figura 14. Mendohem para se t'i bëj gjërat.

Në deklaratën “Mendohem para se t'i bëj gjërat” nga 130 pjesëmarrës në hulumtim, 7.69% (N=10) prej tyre kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, pastaj 15.38% (N=20) kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa në një përqindje më të lartë 76.92% (N=100) prej tyre kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.




Figura 15. E mbaroj (e çoj deri në fund) një punë që e nisi.

Në deklaratën e fundit të këtij konstrukti “E mbaroj (e çoj deri në fund) një punë që e nis)”, nga 130 pjesëmarrës që ishin pjesë e hulumtimi 10% (N=13) prej tyre kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, pastaj 16.15% (N=21) prej tyre kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa 73.85% (N=96) kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.

V.2.4 Analiza përshkruese për shkallën e problemeve të bashkëmoshatarëve

Rezultatet e paraqitura me anë të grafikëve




Figura 16. Zakonisht rri vetëm, luaj vetëm apo mbyllem në vetvete.

Tek konstrukti shkalla e problemeve të bashkëmoshatarëve deklarata e parë është “Zakonisht rri vetëm, luaj vetëm apo mbyllem në vetvete”, ku nga 130 pjesëmarrës, 75.38% (N=98) kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, ndërsa 13.08% (N=17) kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, kurse vetëm 11.54% (N=15) kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.




Figura 17. Kam një apo më shumë shokë të ngushtë.

Në deklaratë tjetër “Kam një apo më shumë shokë të ngushtë” nga 130 pjesëmarrës, 10% (N=13) kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, ndërsa 11.54% (N=15) kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, kurse 78.46% (N=102) kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.




Figura 18. Moshatarëve të mi zakonisht iu pëlqej.

Në deklaratën “Moshatarëve të mi zakonisht iu pëlqej” nga 130 pjesëmarrës vetëm 10% (N=13) kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, pastaj 21.54% (N=28) kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa 68.46% (N=89) kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”, ku kuptojmë se mesatarisht kanë raporte të pëlqyeshme me njëri-tjetrin.




Figura 19. Fëmijët dhe të rinjtë e tjerë kapen me mua dhe më ngacmojnë.

Sa i përket deklaratës “Fëmijët dhe të rinjtë e tjerë kapen me mua dhe më ngacmojnë” nga 130 pjesëmarrës 76.92% (N=100) kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, pastaj në një përqindje shumë më të ulët, 12.31% (N=16) kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa vetëm 10.77% (N=14) kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.




Figura 20. Kaloj më mirë me të rriturit se sa me moshatarët e mi.

Në deklaratën e fundit të këtij konstrukti “Kaloj më mirë me të rriturit se sa me moshtarët e mi”, nga 130 pjesëmarrës që ishin pjesë e hulumtimi 50% (N=63) prej tyre kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, pastaj 30% (N=39) prej tyre kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa 20% (N=26) kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.

V.2.5 Analiza përshkruese për sjelljen prosociale të nxënësve

Rezultatet e paraqitura me anë të grafikëve




Figura 21. Përpiqem të sillem mirë me njerëzit, respektoj ndjenjat e tyre.

Në deklaratën “Përpiqem të sillem mirë me njerëzit, respektoj ndjenjat e tyre” nga 130 pjesëmarrës në hulumtim 9.23 % (N=12) janë përgjigjur se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa pjesa tjetër 90.77% (N=118) janë përgjigjur se kjo është “Shumë e vërtetë”. Pra, asnjë nga pjesëmarrësit në hulumtim nuk janë përgjigjur me “Jo e vërtetë”.




Figura 22. Zakonisht i ndaj gjërat me të tjerët (ushqimin, lojrat, lapsat, etj.).

Ndërsa në deklaratën “Zakonisht i ndaj gjërat me të tjerët (ushqimin, lojrat, lapsat, etj)” nga 130 pjesëmarrës në hulumtim 7.69% (N=10) kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, 16.15% (N=21) kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa 76.15% (N=99) kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.




Figura 23. Ndhimoj nëse dikush lëndohet, shqetësohet apo ndihet i sëmurë.

Sa i përket deklaratës “Ndhimoj nëse dikush lëndohet, shqetësohet apo ndihet i sëmurë” nga 130 pjesëmarrës vetëm 3.85% (N=5) kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, pastaj 13.85% (N=18) kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa 82.31% (N=107) kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.




Figura 24. Sillem mirë me fëmijët më të vegjël.

Në deklaratën “Sillem mirë me fëmijët më të vegjël” nga 130 pjesëmarrës që ishin në total, 6.15% (N=8) kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, vetëm 1.54% (N=2) kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa pjesa tjetër 92.31% (N=120) kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.




Figura 25. Shpesh ndihmoj vullnetarisht të tjerët (prindërit, mësuesit, fëmijët).

Në deklaratën e fundit të këtij konstrukti “Shpesh ndihmoj vullnetarisht të tjerët” nga 130 pjesëmarrës që ishin pjesë e hulumtimi vetëm 3.08% (N=4) prej tyre kanë deklaruar se kjo është “Jo e vërtetë”, pastaj 13.08% (N=17) prej tyre kanë deklaruar se kjo është “Pak e vërtetë”, ndërsa 83.85% (N=109) kanë deklaruar se kjo është “Shumë e vërtetë”.

V.3 Gjetjet kryesore të hulumtimit

Tabela 5. Klasifikimi i konstrukteve dhe niveli i shfaqjes së tyre tek fëmijët të shprehura me mesatare.

	Problemet emocionale	Problemet në sjellje	Shkalla e hiperaktivitetit	Problemet me bashkëmohatarët	Sjellja prosociale
M	2.62	2.23	5.04	4.32	8.99
N	130	130	130	130	130

Në tabelën më lartë është dhënë klasifikimi i konstrukteve (problemet emocionale, problemet në sjellje, shkalla e hiperaktivitetit, shkalla e problemeve të bashkëmohatarët dhe sjellja prosociale) dhe niveli i shfaqjes së tyre tek fëmijët të shprehura me mesatare. Nga raportimi i pjesëmarrësve shohim se më së shumti është e shfaqur sjellja prosociale (M=8.99), gjë për të cilën studimet tregojnë se ndikon në arritjet akademike të fëmijëve. Një nga studimet arrin në përfundim, se në përgjithësi studentët pajtohen se ata kanë nevojë për bashkëmohatarët e tyre dhe i përkasin një grupi bashkëmohatarësh, kështu që kjo mund t'i ndihmojë ata të ndajnë perspektivën dhe kapacitetin e tyre si individ (Moldes, Biton, Gonzaga & Moneva, 2019).

Pastaj në një nivel të lartë është shfaqur edhe shkalla e hiperaktivitetit të fëmijët (M=5.04). Fëmijët hiperaktiv kanë mungesë të theksuar përqendrimi, janë të lëvizshëm, shpërqendrohen shpejt, janë të rrëmbyer e shfaqin rezultate të ulëta në mësim.

Është një ndër çrregullimet më të njohura i cili prek pothuajse të gjitha moshat. Ndryshe njihet si çrregullimi hiperaktiv/mungesës së vëmendjes (ADHD).

Ky zakonisht diagnostifikohet tek fëmijët me shfaqjen e simptomave deri në shtatë vjet. Diagnoza u konfirmua dy herë më shpesh tek djemtë sesa tek vajzat. Simptomat e ADHD-së mund të ndikojnë seriozisht në shumë aspekte të sjelljes dhe performancës në shkollë dhe në shtëpi. ADHD mund të shoqërohet me çrregullime të tjera, të tilla si çrregullimi kundërshtues, çrregullimi i sjelljes, ankthi ose depresioni (Sushevska, Olumchev, Savaeska & Kadri, 2011).

Pastaj, në një nivel mesatar është shprehur edhe shkalla e problemeve të bashkëmohatarëve (M=4.32). Kuptojmë se fëmijët kanë marrëdhënie mesatarisht të mira

me bashkëmoshtarët, meqenëse nuk kemi nivel të lartë të problemeve me bashkëmoshtarët.

Studimet tregojnë se marrëdhëniet e mira me bashkëmoshtarët ndikojnë në arritje të larta akademike, ndërsa në të kundërt ndikojnë në rënie të arritjeve akademike. Ndikimet e bashkëmoshtarëve mund të ndodhin në të gjitha moshat dhe vendet, si në vendet e punës, në shkollë, ose në shoqëri (Deepika & Prema, 2017).

Në një nivel më të ulët janë të shfaqura problemet emocionale ($M=2.62$) si dhe problemet në sjellje ($M=2.23$). Gjë për të cilën studimet tregojnë se gjendja emocionale dhe problemet në sjellje ndikojnë në arritjet akademike.

Nga analiza deskriptive e konstrukteve si dhe nga mesataret e shprehura kuptojmë se fëmijët ndihmojnë në një nivel të lartë njëri-tjetrit, kanë marrëdhënie mesatarisht të mira me bashkëmoshtarët, nivel të ulët të problemeve emocionale dhe problemeve në sjellje.

Këto nivele të shfaqjes së konstrukteve deri më tani janë në përputhshmëri me analizën deskriptive të suksesit të nxënësve, sepse më lartë është treguar se nga 130 pjesëmarrës në hulumtim 56.2% ($N=73$) janë deklaruar se kanë sukses të shkëlqyeshëm, ndërsa 24.6% ($N=32$) janë deklaruar se kanë sukses shumë të mirë.

Mirëpo nga analizat shohim se është një nivel mesatarisht i lartë i shkallës së hiperaktivitetit, i cili ndikon në çrregullim të sjelljes ose probleme në sjellje, marrëdhënie jo të mira me bashkëmoshtarët dhe arritje të ulët akademike.

Nga analiza deskriptive e suksesit të nxënësve 3.8% ($N=5$) janë deklaruar se kanë sukses të mjaftueshëm, ndërsa 15.4% ($N=20$) janë deklaruar se kanë sukses të mirë në shkollë.

Tabela 6. Analiza e T-test mes konstrakteve (problemet emocionale, probleme me sjelljen, hiperaktiviteti, probleme me bashkëmoshatarët dhe sjellja prosociale) dhe gjinisë

	Gjinia				t	p
	Mashkull		Femër			
	M	SD	M	SD		
Problemet emocionale	2.34	2.04	2.89	2.41	1.399	.164
Probleme me sjelljen	2.31	1.78	2.15	1.30	.591	.555
Hiperaktiviteti	5.07	1.86	5.00	1.57	.242	.810
Probleme me bashkëmoshatarët	4.42	1.74	4.22	1.55	-.688	.493
Sjellja prosociale	8.95	2.12	9.03	1.43	.247	.806

Sipas tabelës 8 kuptojmë se nuk ka dallime signifikante, mirëpo ka dallime në mes të gjinive me raportimin mbi problemet emocionale $t(126) = 1.399$, $p = .164$, këtu vërejmë se femrat kanë deklaruar më shumë probleme emocionale ($M = 2.89$, $SD = 2.41$) në raport me meshkujt ($M = 2.34$, $SD = 2.04$). Gjithashtu nuk ka dallime signifikante të të dhënave në raportimin mbi problemet me sjelljen $t(128) = .591$, $p = .555$, mirëpo këtu kuptojmë një ndryshim të kundërt të shfaqjes së problemeve në sjellje në mes të gjinive, kahasar me probleme emocionale, ku vërejmë se meshkujt shfaqin më shumë probleme në sjellje ($M = 2.31$, $SD = 1.78$) se femrat ($M = 2.15$, $SD = 1.30$). Në tabelë shohim se nuk ka dallime signifikante në mes gjinive me raportimin mbi hiperaktivitetin $t(128) = .242$, $p = .810$, nuk ka ndonjë ndryshim të madh midis gjinive, më saktësisht meshkujt kanë raportuar një nivel pak më të lartë të hiperaktivitetit ($M = 5.07$, $SD = 1.86$), në raport me femrat ($M = 5.0$, $SD = 1.57$).

Shohim se nuk ka dallime signifikante, por ka dallime në mes gjinive në raportimin mbi problemet me bashkëmoshatarët $t(128) = -.688$, $p = .493$, ku vërejmë se femrat kanë shkallë më të ulët të problemeve me bashkëmosharët ($M = 4.22$, $SD = 1.55$) në krahasim me meshkujt ($M = 4.42$, $SD = 1.74$). Për raportimin në sjellje prosociale shohim se nuk ka dallime signifikante $t(128) = .247$, $p = .806$. Dallimet në mes gjinive nuk janë shumë të mëdha, mirëpo femrat kanë deklaruar se shfaqin më shumë sjellje prosociale ($M = 9.3$, $SD = 1.43$), se sa meshkujt ($M = 8.95$, $SD = 2.12$).

Tabela 7. Analiza e Korrelacionit në mes konstrakteve të SDQ-së me suksesin e përgjithshëm të nxënësve.

		Suksesi i përgjithshëm	Probleme emocionale	Probleme me sjelljen	Hiperaktiviteti	Probleme me bashkëmoshatarë	Sjellja prosociale
Suksesi i përgjithshëm	R	-					
	P						
Probleme emocionale	R	-.069	-				
	P	.440					
Probleme me sjelljen	R	.005	.406**	-			
	P	.951	.000				
Hiperaktiviteti	R	-.068	.338**	.296**	-		
	P	.445	.000	.001			
Probleme me bashkëmoshatarët	R	.187*	-.322**	.211*	.178*	-	
	P	.034	.000	.016	.042		
Sjellja prosociale	R	.208*	.000	.041	.040	.143	-
	P	.017	.997	.640	.649	.104	

Për të parë lidhjen në mes konstrakteve të SDQ-së me suksesin e përgjithshëm të nxënësve, atëherë u bë analiza korrelative e Spearman-it.

Nga tabela shohim se nuk ka lidhje dhe rëndësi statistikore mes shkallës së “Problemeve emocionale” me “Suksesin e përgjithshëm të nxënësve” ($r=-.069$, $p=.440$).

Po ashtu, rezultatet treguan se nuk ka lidhje dhe rëndësi statistikore mes shkallës së “Problemeve në sjellje” dhe “Suksesit të përgjithshëm të nxënësve” ($r=.005$, $p=.951$), mirëpo rezultatet treguan se ka korrelacion pozitiv në mes shkallës së “Problemeve në sjellje” me shkallën e “Problemeve emocionale” ($r=.406^{**}$, $p=.000$). Ky korrelacion është signifikant dhe i moderuar.

Nga tabela shohim se po ashtu nuk ka korrelacion dhe rëndësi statistikore në mes shkallës së “Hiperaktivitetit” dhe “Suksesit të përgjithshëm të nxënësve”(r=-.068, p=.445). Mirëpo rezultatet treguan se shkalla e “Hiperaktivitetit “ ka korrelacion me shkallën e “Problemeve emocionale” (r=.338**, p=.000). Ky korrelacion është signifikant, pozitiv dhe i moderuar. Gjithashtu shkalla e “Hiperaktivitetit” ka lidhje të rëndësishme statistikore me “Problemet në sjellje” (r=.296**, p=.001). Kjo lidhje është pozitive dhe e dobët.

Rezultatet treguan se ka lidhje të rëndësishme statistikore në mes të “Problemeve me bashkëmoshatarët” dhe “Suksesit të përgjithshëm të nxënësve” (r=.187, p=.034). Kjo lidhje është pozitive dhe e dobët.

Konstrukti “Problemet me bashkëmoshatarët” gjithashtu ka korrelacion me të gjitha konstruktet e tjera, ka korrelacion negativ me “ Problemet emocionale” (r=-.322**, p=.000). Ky korrelacion është signifikant dhe i moderuar.

Konstrukti “Problemet me bashkëmoshatarët” ka lidhje të rëndësishme statistikore me konstruktin “ Problemet në sjellje” (r=.211*, p=.016). Kjo lidhje është pozitive dhe e dobët. Poashtu “Problemet me bashkëmoshatarët” kanë korrelacion pozitiv me “ Hiperaktivitetin” (r=.178*, p=.042). Ky korrelacion është signifikant dhe i dobët.

Rezultatet treguan se “Sjellja prosociale” ka lidhje të rëndësishme statistikore me “Suksesin e përgjithshëm të nxënësve” (r=.208*, p=.017). Kjo lidhje është pozitive dhe e dobët.

Nga tabela shohim se “Sjellja prosociale” me “Problemet emocionale” nuk kanë lidhje të rëndësishme statistikore (r=.000, p=.997). Poashtu rezultatet treguan se kjo shkallë “Sjellja prosociale” nuk ka lidhje dhe rëndësi statistikore as me shkallën e “Problemeve në sjellje” (r=.041, p=.640), “Hiperaktivitetin” (r=.040, p=.649), “Problemet me bashkëmoshatarët” (r=.143, p=.104).

Pra, sa i përket konstruktit të “ Sjelljes prosociale ” ka lidhje të rëndësishme statistikore vetëm me “Suksesin e përgjithshëm të nxënësve”.

Vlenë të përmendet se nga rezultatet e dala shihet se konstruktet e SDQ-së në përgjithësi kanë lidhje të rëndësishme statistikore me njëra me tjetrën.

Tabela 8. Analiza e Anoves mes konstruktit “Probleme me bashkëmoshatarët” dhe “Suksesit të nxënësve”.

	Df	ss	ms	f	p
Probleme me bashkëmoshatarët					
Mes grupeve	3	8.758	2.919	1.084	.035
Brenda grupeve	126	339.3	2.693		
Total	129	348.0			

	Suksesi	M	SD
Problemet me bashkëmoshatarët	Mjaftueshëm	5.60	1.342
	Mirë	4.35	1.814
	Shumë mirë	4.25	1.524
	Shkëlqyeshëm	4.24	1.656

Sipas rezultateve të Anoves, ka dallime signifikante në mes të grupeve në konstruktin “Probleme me bashkëmoshatarët” dhe “Suksesit të përgjithshëm të nxënësve” $F(3)=1.084$, $p=.035$. Vërehen disa dallime mes pjesëmarrësve, më saktësisht, nxënësit të cilët kishin sukses të “Mjaftueshëm” treguan nivel më të lartë të problemeve me bashkëmoshatarët ($M=5.60$, $SD=1.342$), pastaj vërehet se me ngritjen e suksesit bie niveli i problemeve me bashkëmoshatarët, ku mesatarja tek nxënësit me sukses “Mirë” është ($M=4.35$, $SD=1.814$), tek nxënësit me sukses “Shumë të mirë” është ($M=4.25$, $SD=1.524$), ndërsa nxënësit me sukses “Shkëlqyeshëm” raportuan se kishin nivelin më të ulët të problemeve me bashkëmoshatarët ($M=4.24$, $SD=1.656$).




Figura 26. Problemet me bashkëmoshatarët dhe suksesi i përgjithshëm i nxënësve.

Të dhënat tregojnë se ka dallime signifikante në mes të konstruktit të problemeve të bashkëmoshatarëve dhe suksesit të përgjithshëm të nxënësve. Sipas grafikut, nxënësit me sukses të mjaftueshëm kanë treguar mesatare më të lartë në problemet me bashkëmoshatarët e tyre ($M = 5.60$), ndërsa mesatare më të ulët e kanë treguar nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm ($M = 4.247$). Pra, grafiku tregon se sa më i lartë suksesi i nxënësve në shkollë aq më të mira janë marrëdhëniet mes bashkëmoshatarëve dhe anasjelltas.

Tabela 9. Analiza e Anoves mes konstruktit të “Sjelljes prosociale” dhe “Suksesit të nxënësve”.

	Df	ss	ms	f	p
Sjellja prosociale					
Mes grupeve	3	24.288	8.096	2.652	.051
Brenda grupeve	126	339.704	3.052		
Total	129	363.992			

	Suksesi	M	SD
Sjellja prosociale	Mjaftueshëm	8.67	2.309
	Mirë	8.15	2.764
	Shumë mirë	8.59	2.190
	Shkëlqyeshëm	9.33	1.267

Të dhënat tregojnë se ka dallime signifikante në shkallën e sjelljes prosociale dhe suksesit të nxënësve, $F(3)=2.652$, $p=.051$.

Vërehen disa dallime mes kategorive, më saktësisht, nxënësit të cilët kishin sukses të ”Mirë” treguan nivel më të ulët të sjelljes prosociale ($M=8.15$, $SD=2.309$), pastaj mes kategorive të nxënësve me sukses të mjaftueshëm dhe shumë të mirë nuk ekziston ndonjë diferencë e lartë, ku nxënësit me sukses ”Mjaftueshëm” kanë nivel pak më të lartë të sjelljes prosociale ($M=8.67$, $SD=2.309$) në krahasim me nxënësit me sukses ”Shumë të mirë” ($M=8.59$, $SD=2.190$). Mirëpo rezultatet tregojnë se nivel më të lartë të sjelljes prosociale kanë raportuar nxënësit të cilët kanë sukses të shkëlqyeshëm ($M=9.33$, $SD=1.26$).




Figura 27. Sjellja prosociale dhe suksesi i përgjithshëm i nxënësve.

Të dhënat tregojnë se ka dallime signifkante në shkallën e sjelljes prosociale dhe suksesit të nxënësve $F(3) = 2.652, p = .051$. Në grafikun e paraqitur lart shohim se nxënësit me sukses "Mirë" kanë treguar mesatare më të ulët në shkallën e sjelljes prosociale ($M = 8.153, SD = 2.764$), ndërsa nxënësit me sukses "Të shkëlqyeshëm" kanë treguar mesatare më të lartë në shkallën e sjelljes prosociale ($M = 9.329, SD = 1.267$) në krahasim me të gjitha grupet e tjera. Nga këto të dhëna kuptojmë se sa më e lartë është shkalla e sjelljes prosociale aq më i lartë është suksesi i nxënësve në shkollë.




Figura 28. Problemët emocionale dhe suksesi i përgjithshëm i nxënësve.

Në mënyrë grafike është paraqitur edhe analiza e Anovës në mes konstruktit "Probleme emocionale" dhe "Suksesit të përgjithshëm të nxënësve"

$F(3) = .913$, $p = .437$. Të dhënat tregojnë se nuk ka dallime signifikante në shkallën e problemeve emocionale dhe suksesit të nxënësve. Mirëpo sipas grafikut të paraqitur shohim se nxënësit me sukses "Mjaftueshëm" kanë treguar mesatare më të lartë në shkallën e problemeve emocionale ($M = 4.20$, $SD = 4.025$), ndërsa nxënësit me sukses "Të mirë" ($M=2.45$, $SD=2.164$), "Shumë të mirë" ($M=2.71$, $SD=1.829$) dhe "Të shkëlqyeshëm" ($M=2.53$, $SD=2.301$) nuk kanë dallime të mëdha lidhur me shkallën në problemet emocionale, por që tregojnë nivel shumë më të ulët të mesatares në krahasim me nxënësit që kanë sukses të mjaftueshëm. Prandaj, mund të themi që nxënësit të cilët kanë probleme emocionale kanë performancë të ulët akademike.




Figure 29. Probleme me sjelljen dhe suksesi i përgjithshëm i nxënësve.

Po ashtu, në mënyrë grafike është paraqitur edhe analiza e Anovës në mes konstruktit "Probleme me sjelljen" dhe "Suksesit të përgjithshëm të nxënësve"

Të dhënat tregojnë se nuk ka dallime signifikante në shkallën e problemeve në sjellje dhe suksesit të nxënësve $F(3) = .137, p = .938$. Ndonëse vërehen disa dallime në mes të pjesëmarrësve sa i përket mesatares. Sipas grafikut të paraqitur shohim se nxënësit me sukses "Mjaftueshëm" kanë treguar mesatare më të lartë në shkallën e problemeve me sjelljen ($M = 2.60, SD = 1.517$), ndërsa nxënësit me sukses "Të mirë" kanë treguar nivel më të ulët të problemeve në sjellje ($M=2.10, SD=1.651$), pastaj nuk ka ndonjë ndryshim shumë të madh tek nxënësit me sukses "Shumë të mirë" ku mesatarja është ($M=2.25, SD=1.344$) dhe në fund vërehet një rënie e shkallës së problemeve në sjellje tek nxënësit të cilët kanë sukses "Të shkëlqyeshëm" ($M=2.23, SD=1.671$).

Po ashtu, as te konstruktin e problemeve në sjellje nuk ka dallime të mëdha sa i përket mesatares tek nxënësit me sukses të mirë, shumë të mirë dhe të shkëlqyeshëm. Pra, grafiku na tregon se nxënësit e suksesshëm në shkollë kanë më pak probleme në sjellje.




Figura 30. Hiperaktiviteti dhe suksesi i përgjithshëm i nxënësve.

Në grafik është paraqitur analiza e Anovës në mes konstruktit të hiperaktivitetit dhe suksesit të përgjithshëm të nxënësve

Të dhënat tregojnë se nuk ka dallime signifikante në shkallën e hiperaktivitetit dhe suksesit të nxënësve $F(3) = .871, p = .458$. Mirëpo vërehen dallime të konsiderueshme midis grupeve. Në grafikun e paraqitur lart vërehet se nga të gjitha grupet nivel më të lartë të shkallës së hiperaktivitetit kanë fëmijët me sukses “Të mjaftueshëm” ($M=5.60, SD=2.702$), ndërsa nivel më të ulët të shkallës së hiperaktivitetit kanë fëmijët të cilët kanë raportuar sukses “Të shkëlqyeshëm” ($M=4.85, SD=1.656$). Ndërsa të fëmijët me sukses “Të mirë” dhe “Shumë të mirë” nuk vërehen dallime të mëdha në shkallën e hiperaktivitetit, më saktësisht fëmijët me sukses “Të mirë” ($M=5.05, SD=1.986$) kanë një nivel pak më të ulët në krahasim me fëmijët të cilët kanë sukses “Shumë të mirë” ($M=5.38, SD=1.561$).

Pra, grafiku na tregon se sa më e ulët të jetë shkalla e hiperaktivitetit aq më i lartë është suksesi i nxënësve në shkollë dhe anasjelltas.

VI. DISKUTIME DHE KONKLUDIMET

Më poshtë janë përmbledhur rezultatet kryesore të studimit dhe është bërë diskutimi i tyre. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të shpjegohet lidhja ndërmjet presionit të bashkëmoshatarëve dhe arritjeve akademike të nxënësve të klasëve të pesta të shkollave fillore në qytetin e Vushtrrisë.

Në këtë kontekst janë ngritur edhe pyetjet kërkimore të studimit dhe janë studiuar korrelacionet midis variablave përkatëse. Qëllimi kryesor i kësaj çështjeje është diskutimi i gjetjeve kryesore. Pas mbledhjes së të dhënave u analizuan rezultatet në përpjekje për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe duke i krahasuar edhe me studime të tjera nga autorët e ndryshëm.

Pyetja kërkimore 1: Cilat janë dallimet gjinore në shkallën e problemeve në sjellje?

Për të parë nëse ka dallime gjinore në shkallën e problemeve në sjellje u bë analiza e T-Test-it. Rezultatet nga analiza e T-Test-it në tabelën 6 tregojnë se nuk ka dallime signifikante në mes gjinive lidhur me problemet në sjellje, mirëpo ka dallime gjinore në mesatare, djemtë kanë më shumë probleme në sjellje sesa vajzat.

Rezultate të ngjashme tregojnë edhe hulumtimet e tjera, sipas një hulumtimi djemtë kanë më shumë gjasa se vajzat të vuajnë nga çrregullime të sjelljes. Është e paqartë nëse shkak është gjenetik ose i lidhur me përvojat e socializimit (Gupta, Mongia & Garg, 2017). Prandaj hipoteza e parë e këtij hulumtimi “Djemtë kanë më shumë probleme në sjellje sesa vajzat” është vërtetuar.

Pyetja kërkimore 2. Çfarë është dallimi gjinor në shkallën e sjelljes prosociale?

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se ka dallime gjinore në shkallën e sjelljes prosociale. Nga tabela 6 me anë të analizës së T-Test-it tregohet se nuk ka dallime signifikante në mes gjinive lidhur me sjelljen prosociale, mirëpo ka dallim gjinor në mesatare, ku femrat janë më prosociale sesa djemtë.

Gjithashtu edhe hipoteza e dytë “Vajzat kanë nivel më të lartë të sjelljes prosociale sesa djemtë”, është vërtetuar.

Këtë rezultate e mbështetën edhe disa hulumtime të tjera. Hulumtimet tregojnë se djemtë raportojnë nivele më të ulëta të sjelljes prosociale sesa vajzat (Graaff, Carlo, Crocetti, Koot & Branje, 2017).

Pyetja kërkimore 3: Si ndërlidhet sjellja prosociale me suksesin e nxënësve?

Rezultatet e këtij studimi nga analiza e korrelacionit tregojnë se ka lidhshmëri në mes të sjelljes prosociale dhe suksesit të nxënësve në shkollë (tabela 7), gjithashtu nga analiza e Anovës, tabela 9 dhe nga grafiku “Sjellja prosociale” dhe “Suksesit të përgjithshëm të nxënësve” rezultatet tregojnë se nxënësit të cilët kanë sukses të shkëlqyeshëm kanë raportuar nivel të lartë të sjelljes prosociale, për dallim nga nxënësit me sukses të mjaftushëm dhe të mirë, të cilët kanë raportuar nivel shumë më të ulët të sjelljes prosociale.

Prandaj edhe hipoteza e tretë: “Nxënësit me sjellje prosociale kanë performancë më të lartë akademike”, është vërtetuar.

Ngjashëm edhe hulumtimet e tjera tregojnë se sjellja prosociale apo sjellja vullnetare, është e lidhur me disa rezultate pozitive, duke përfshirë suksesin në shkollë (Graaff, Carlo, Crocetti, Koot & Branje, 2017). Fëmijët me sjellje prosociale bashkëveprojnë me bashkëmoshatarët e tyre si dhe ndihmojnë njëri-tjetrin për të pasur rezultate sa më të mira në mësim.

Pyetja kërkimore 4: Si ndërlidhen marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve në arritjet akademike të nxënësve?

Nxënësit në shkollë krijojnë marrëdhënie me bashkëmoshatarët e tyre, të cilat mund të jenë marrëdhënie të mira dhe jo të mira, si dhe mund të përballen me probleme të shumta, duke iu ekspozuar presionit si një faktor i cili zvogëlon arritjet akademike të nxënësve.

Rezultatet e hulumtimeve të tjera raportojnë se ka lidhje mes marrëdhënieve të bashkëmoshatarëve dhe suksesit të tyre në shkollë. Sipas një hulumtimi, fëmijët të cilët kanë marrëdhënie të mira me bashkëmoshatarët kanë sukses më të mirë në shkollë. Ndërsa fëmijët të cilët nuk kanë marrëdhënie të mira dhe refuzohen nga bashkëmoshatarët e tyre kanë sukses të dobët në shkollë e disa prej tyre braktisin shkollën (Gale, 2008).

Prandaj, sa i përket pyetjes së katërt se “Si ndërlidhen marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve me arritjet akademike të nxënësve?”, rezultatet e këtij studimi nga analiza e korrelacionit (Tabela 7) tregojnë se ka lidhje mes marrëdhënieve të bashkëmoshatarëve përkatësisht problemeve të bashkëmoshatarëve dhe suksesit të tyre në shkollë, ndërsa hipoteza e katërt: “Nxënësit të cilët kanë marrëdhënie të mira me bashkëmoshatarët kanë sukses më

të lartë në shkollë”, është vërtetuar. Gjithashtu nga analiza e Anovë, tabela 8 dhe nga grafiku “Problemet e bashkëmoshatarëve” dhe “Suksesit të përgjithshëm të nxënësve” është treguar se nxënësit të cilët kanë probleme me bashkëmoshatarët rezultojnë me sukses të ulët në arritje akademike, ndërsa nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm kanë raportuar shumë më pak probleme me bashkëmoshatarët.

Nga ky studim kuptojmë se nxënësit përballen me probleme të ndryshme gjatë procesit mësimor të cilat ndikojnë në arritjet akademike të tyre. Para se nxënësit të gjykohen për suksesin e tyre nga prindërit apo mësimdhënësit është e domosdoshme të identifikohen faktorët të cilët po ndikojnë në arritjet akademike të tyre, duke përfshirë problemet emocionale, shkallën e hiperaktivitetit, sjelljen prosociale si dhe marrëdhëniet jo të mira me bashkëmoshatarët, apo edhe probleme të natyrave të tjera.

Nga gjithë ajo që është trajtuar në këtë punim, arrijmë në përfundim se presioni është një faktor që lidhet me suksesin e nxënësve. Prandaj rezultatet e këtij punimi mund të ndihmojnë në të kuptuarit e faktorëve të ndryshëm që shkaktojnë presion si dhe mënyrat e duhura të trajtimit të tij. Pra, ajo çfarë duhet bërë është të gjenden mënyra të ndryshme për të trajtuar presionin në mënyrë që ky presion të mos ndikojë në suksesin e tyre. Por, fenomenin e presionit ta konsiderojnë si shtytës drejt suksesit.

VI.1 Limitet/ kufizimet në hulumtim

Për trajtimin e kësaj çështje është punuar me shumë përkushtim, por prapë se prapë ky hulumtim nuk kaloi pa hasur në disa kufizime.

Së pari po cekim si kufizim numrin e vogël të pjesëmarrësve në pamundësi për t'i pasur pjesëmarrës të gjithë fëmijët e kësaj moshe, po jemi ndalur vetëm në qytetin e Vushtrrisë, duke përjashtuar fshatrat e kësaj komune.

Pastaj, duke pasur parasysh që instrumenti ka qenë i përbërë nga dy pyetësor dhe i realizuar në kohë pandemie, ku orari mësimor ishte jo i plotë, nxënësit ka pasur mundësi që në pjesën e fundit janë shpërqendruar e të kenë humbur durimin për të plotësuar në mënyrë të drejtë për arsye të kohës.

VI.2 Implikimet praktike nga studimi

Rezultatet e këtij studimi kanë rëndësi të mëdha në gjithë procesin mësimor të fëmijëve dhe janë adekuate të shqyrtohen nga mësime dhënësit dhe prindërit. Si prindërit ashtu edhe mësime dhënësit synojnë më të mirën e mundshme për fëmijët (nxënësit) e tyre, prandaj këto rezultate mund t'i shërbejnë të dy palëve që të trajtojnë fenomenin e presionit në favor të fëmijëve. Gjithashtu rezultatet e këtij hulumtimi ndihmojnë prindërit dhe mësime dhënësit që të identifikojnë faktorët e mundshëm të cilët ndikojnë në arritjet akademike, nëse janë të shprehur ndonjëri nga faktorët e trajtuar gjatë punimit, t'i ndihmojnë fëmijët në eliminimin e tyre dhe kështu të përmirësohet gjendja aktuale e fëmijëve të tyre në arritjet akademike.

VII. PËRFUNDIME

Shkolla është një vend shoqëror në të cilën fëmijët krijojnë lidhjet e para me bashkëmoshatarët e tyre. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se ka lidhshmëri mes marrëdhënieve të bashkëmoshatarëve dhe suksesit të tyre në shkollë, gjithashtu edhe rezultatet e hulumtimeve të tjera tregojnë se marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve kanë një rëndësi në zhvillimin e fëmijëve dhe në suksesin e tyre në shkollë. Sa më të mira të jenë marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve aq më të suksesshëm janë fëmijët, ndërsa sa më shumë të ketë probleme me bashkëmoshatarët, përkatësisht marrëdhënie jo të mira suksesi i nxënësve do të jetë më i ulët, pra jo gjithmonë marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve janë të mira sepse grupet shoqërore mund të përbëhen nga fëmijë të ndryshëm duke përfshirë fëmijët me probleme në sjellje të cilët janë më agresiv dhe kërkojnë të jenë “lider” në grupin shoqëror e nga kjo vjen edhe presioni i bashkëmoshatarëve, i cili ndikon tek fëmijët si në krijimin e shprehive jo të mira ashtu edhe në performancën akademike.

Ndërsa rezultatet e tjera të hulumtimit tregojnë se nxënësit me sjellje prosociale janë më të suksesshëm në shkollë dhe kanë marrëdhënie më të mira me bashkëmoshatarët.

Po ashtu nga rezultatet e hulumtimit kuptojmë lidhshmërinë e arritjeve akademike me problemet emocionale, problemet me sjelljen dhe hiperaktivitetin.

Si përfundim duke marrë parasysh rezultatet e hulumtimit, si mësimdhënës duhet të tregohemi të kujdesshëm në vetëdijësimin e nxënësve për sjelljet e tyre të cilat mund të ndikojnë tek bashkëmoshatarët e tyre, të identifikohen vështirësit e nxënësve, të nxisim bashkëpunim tek nxënësit dhe të gjejmë mënyrën më të mirë për ta trajtuar presionin, pra nxënësit presionin ta shohin në aspektin pozitiv.

Ne duhet inkurajuar fëmijët që të bashkëpunojnë me të tjerët, t'i ndihmojnë njëri-tjetrit, të kenë marrëdhënie të mira me shokët dhe shoqet e klasës, të flasin lirshëm duke shprehur kështu gjendjen e tyre emocionale, pasi që në këtë mënyrë reduktohen edhe sjelljet e papërshtatshme.

Duke vepruar në mënyrë të drejtë në trajtimin e këtyre faktorëve, do të ndikojmë në arritjet të larta akademike të fëmijëve.

LITERATURA

Akhtar, Z. (2011). The Effect of Peer and Parent Pressure on the Academic Achievement of University Students. *Research Gate*. Marrë nga:

https://www.researchgate.net/publication/231582200_The_Effect_of_Peer_and_Parent_Pressure_on_the_Academic_Achievement_of_University_Students

Andreou, E. (2010). Bully/victim problems and their association with Machiavellianism and self- efficacy in Greek primary school children. *British Journal of Educational Psychology*. Volume 74, Issue 2, fq. 297-309.

Marrë nga <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/abs/10.1348/000709904773839897>

American Academy of Children and Adolescent Psychiatry. (2019). Peer pressure. *Facts for families*. Article 104. Marrë nga:

https://www.aacap.org/aacap/families_and_youth/facts_for_families/fff-guide/peer-pressure-104.aspx

Bierman, K. L. (2004). *Peer rejection: Developmental processes and intervention strategies*. Guilford Press. Marrë nga: <https://psycnet.apa.org/record/2004-13850-000>

Coulson, J. (2015, shtator 10). Peer pressure at school. *Kidspot*. Marrë nga: <https://www.kidspot.com.au/school/secondary/peer-pressure/peer-pressure-at-school/news-story/4fafcfe5bbc8c458c698df4bfc18d484>

Cherry, K. (2018, nëntor 21). The basics of prosocial behaviour. *Very well mind*. Marrë nga: <https://www.verywellmind.com/what-is-prosocial-behavior-2795479>

Davis, J. R. (2014). A Little Goes a Long Way: Pressure for College Students to Succeed. *The Journal of Undergraduate*, Vol. 12 , Article 2.

Marrë nga: <https://openprairie.sdstate.edu/jur/vol12/iss1/2>

Dumas, T. M., Ellis, W. E., & Wolfe, D. A. (2012). Identity development as a buffer of adolescent risk behaviors in the context of peer group pressure and control. *Journal of adolescence*, 35(4), 917-927.

Marrë nga: <https://www.sciencedirect.com/science/article/abs/pii/S0140197111001801>

Deepika, K., & Prema, N. (2017). Peer Pressure in Relation to Academic Achievement of Deviant Students. *International Journal of Environmental and Science Education*, 12(8), 1931-1943.

Marrë nga: http://www.ijese.net/makale_indir/IJESE_1952_article_59f85b5e04320.pdf

Esen, B. K., & Gündoğdu, M. (2010). The relationship between internet addiction, peer pressure and perceived social support among adolescents. *The International Journal of Educational Researchers*, 2(1), 29-36.

Marrë nga: <https://ijer.penpublishing.net/makale/37>

Falade, O. (2021, mars 11). The impact of peer pressure on the Academic Performance of senior secondary school students in Education district VI Oshadi in Logos state. *Project Gist*. Marrë nga: <https://projectgist.com.ng/2021/03/11/the-impact-of-peer-pressure-on-the-academic-performance-of-senior-secondary-school-students-in-education-district-vi-oshodi-in-lagos-state/>

Gale, Th. (2008). Peer effects. *Encyclopedia.com*.

Marre nga: <https://www.encyclopedia.com/social-sciences/applied-and-social-sciences-magazines/peer-effects>

Gupta, A.K., Mongia, M & Garg, A.K. (2017). A descriptive study of behavioral problems in schoolgoing children. *Industrial Psychiatry Journal*. Marrë nga linku <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC5810175/>

Graaff, J.V., Carlo. G., Crocetti. E, Koot.H.M & Branje.S. (2017, nëntor 28). Prosocial behavior in adolescence: Gender differences in development and links with empathy. *Empirical research*.

Marre nga: <https://link.springer.com/content/pdf/10.1007%2Fs10964-017-0786-1.pdf>

Hajdari, F. (2016, 29, shkurt). Çrregullimet e sjelljes (ÇS) tek fëmijët dhe adoleshentët. *Zëri*. Marrë nga: <https://zeri.info/shendetesi/78461/crregullimet-e-sjelljes-cs-tek-femijet-dhe-adoleshentet/>

Johnson, K. A. (2000). The Peer Effect on Academic Achievement among Public Elementary School Students. A Report of the Heritage Center for Data Analysis.

Marrë nga: <https://eric.ed.gov/?id=ED442916>

Kanhere, A.M, (2018, 06, mars). Types of peer pressure. *AptParenting*. Marrë nga: <https://aptparenting.com/types-of-peer-pressure>

Khan, A. (2019, 19, mars). What is peer pressure? How school students can deal with it? *Josh*. Marrë nga linku <https://www.jagranjosh.com/articles/peer-pressure-on-students-and-how-to-deal-with-it-1495623543-1>

- Lay, J.C & Hoopmann, Ch.A. (2015, maj 20). Altruism and prosocial behavior. *Encyclopedia of Geropsychology*. Marrë nga: https://link.springer.com/referenceworkentry/10.1007%2F978-981-287-080-3_69-1
- Lyness, A. (2015, korrik). Dealing with peer pressure. *KidsHealth/Kids*. Marrë nga: <https://kidshealth.org/en/kids/peer-pressure.html>
- Ladd, G. W. (1990). Having friends, keeping friends, making friends, and being liked by peers in the classroom: Predictors of children's early school adjustment?. *Child development*, 61(4), 1081-1100. Marrë nga: <https://srcd.onlinelibrary.wiley.com/doi/abs/10.1111/j.1467-8624.1990.tb02843.x>
- Leka, I. (2015). The impact of peer relations in the academic process among adolescents. *Mediterranean Journal of Social Sciences*, 6(1 S1), 127-127. Marrë nga: <https://www.richtmann.org/journal/index.php/mjss/article/view/5518>
- Lockhart, A. L. T. (2020, shtator 22). The Dangers of Putting Too Much Pressure on Kids. *Verywellfamily*.
Marrë nga: <https://www.verywellfamily.com/the-dangers-of-putting-too-much-pressure-on-kids-1094823>
- Moldes, V. M., Biton, C. L., Gonzaga, D. J., & Moneva, J. C. (2019). Students, peer pressure and their academic performance in school. *International Journal of Scientific and Research Publications*, 9(1), 2250-3153.
Marrë nga: <http://www.ijsrp.org/research-paper-0119.php?rp=P858140>
- Maunder, R & Monks, C.P. (2018, 31, dhjetor). Friendships in middle childhood: Links to peer and school identification, and general self-worth. *Wiley Online Library*.
Marrë nga: <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/full/10.1111/bjdp.12268>
- Nair, A. (2019, nëntor 1). Parental pressure on kids- signs and effects. *Firstcry parenting*. Marrë nga: <https://parenting.firstcry.com/articles/parental-pressure-on-kids-signs-and-effects/>
- Nkpolu-Oroworukwo, P. H. (2021). Peer pressure as a contemporary issue in teenage upbringing in Obio/Akpor LGA of rivers state. *International Journal of Home Science*.7(1), 21-27. Marrë nga: <https://www.homesciencejournal.com/archives/2021/vol7issue1/PartA/6-3-109-767.pdf>

Nushi, P. (2018, 01, dhjetor). Çrregullimet e sjelljes te fëmijët dhe menaxhimi i tyre. *Kallxo*. Marrë nga linku <https://kallxo.com/ndryshe/crregullimet-e-sjelljes-te-femijet-dhe-menaxhimi-i-tyre/>

Olalekan, A. B. (2016). Influence of peer group relationship on the academic performance of students in secondary schools: A case study of selected secondary schools in Atiba Local Government Area of Oyo State. *Global Journal of Human-Social Science*, 16(4), 89-94. Marrë nga:

https://www.researchgate.net/profile/Basit-Ajibade/publication/350063687_Influence_of_Peer_Group_Relationship_on_the_Academic_Performance_of_Students_in_Secondary_Schools_A_Case_Study_of_Selected_Secondary_Schools_in_Atiba_Local_Government_Area_of_Oyo_State/links/604f3a9b92851c2b23cdba04/Influence-of-Peer-Group-Relationship-on-the-Academic-Performance-of-Students-in-Secondary-Schools-A-Case-Study-of-Selected-Secondary-Schools-in-Atiba-Local-Government-Area-of-Oyo-State.pdf

Pappas, S. (2017, shtator 7). Personality traits & Personality types. *Live Science*. Marrë nga: <https://www.livescience.com/41313-personality-traits.html>

Packer, J. (2014, mars 31). Peer pressure & Influences: How to say ‘‘NO’’. *Jeff Packer MSW & Associates Inc*. Marrë nga: <https://jeffpacker.com/peer-pressure-influences-how-to-say-no>

Padma. (2014, 05, gusht). 6 negative effects of peer- pressure. *The teachers digest*. Marrë nga: <http://theteachersdigest.com/6-ways-in-which-children-are-negatively-affected-by-peer-pressure/>

Rubin, K. (2015). Peer Relationships. *Research Gate*.

Marrë nga: https://www.researchgate.net/publication/291344594_Peer_relationships

Reich, P.A. (2012, dhjetor 10). Effects of peer influences on academic performance. *ResearchGate*. Marre nga:

https://www.researchgate.net/publication/308209943_Effects_of_Peer_Influences_on_Academic_Performance_A_Literature_Review

Statovci-Shala,S, (2014). Presioni nga nxënësit problematikë në shkollë. *Shkaqet e humbjes së interesimit të nxënësve për mësim (fq. 25)*. Prishtinë, Kosovë: Instituti Pedagogjik i Kosovës.

Seifert, K. (2012, 30, tetor). How to resist peer pressure. *Parent and Teacher Choice Awards*. Marrë nga: <https://www.howtolearn.com/2012/10/how-to-resist-peer-pressure/>

Sushevska, L., Olumchev, N., Savaeska, M., & Kadri, H. (2011). Analysis of subtypes and other associated conditions of attention deficit and hyperactivity disorder (ADHD) in school population from 6 to 12 years of age. *Scientific Journal of the Faculty of Medicine in Niš*, 28(1), 53-58.

Marrë nga: https://publisher.medfak.ni.ac.rs/AFMN_1/2011/1-2011/6.pdf

Shala, M. (2013). Doracak për këshillat e nxënësve. *Weebly.com*. Marrë nga: http://naserkastrati.weebly.com/uploads/3/8/8/3/38831473/doracak-per-keshillat-e-nxenesve_botimi-i-i-re_maj-2013_final.pdf

Shin, K.M., Cho, S.M., Shin, Y.M & Park, K.S. (2016, 25, korrik). Effects of early childhood peer relationships on adolescent mental health: A 6- to 8- year follow-up study in South Korea. *Psychiatry Investigation*. Marrë nga: <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC4965647/>

Treynor, W. (2009). Understanding Human Cruelty, Human Misery, and, Perhaps, a Remedy. A Theory of the Socialization Process (fq. 272-273). *Euphoria Press*. Marrë nga: <https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/15528030.2011.563227>

Woolfolk, A.(2011). Bashkëmoshatarët. *Psikologji Edukmi* (fq. 70). Tiranë, Shqipëri: Qendra për arsim demokratik.

SHTOJCA

SHTOJCA 1. Pyetësoni demografik dhe pyetësoni i Avantazheve dhe Vështirësive

Emri i personit që mbush pyetësonin: _____

Dita e lindjes: _____

Mashkull Femër

Suksesi i përgjithshëm: _____

Vendbanimi: Fshat Qytet

Nota juaj në lënden e gjuhës shqipe: _____

Nota juaj në lënden e matematikës: _____

Nota juaj në lënden njeriu dhe natyra: _____

Për secilin pohim ju lutem shënoni njëren nga opsionet: “jo e vërtetë”, “pak e vërtetë”, “shumë e vërtetë”. Do të na ndihmonte nëse do t’ju përgjigjeshit të gjitha pohimeve sa më saktë të jetë e mundur edhe nëse nuk jeni plotësisht të sigurtë ose nëse deklarimi duket kot!

Përgjigjuni pyetjeve duke marrë parasysh gjendjen tuaj gjatë 6 muajve të fundit.

Nr.	Deklaratat			
	Ju lutem lexoni secilën me kujdes dhe vendosni X tek kutia përpara fjalëve që më së miri përshkruajnë veten tuaj. Nuk ka përgjigje të sakta ose të gabuara.	Jo e vërtetë	Pak e vërtetë	Shumë e vërtetë
1	<u>Përiqem të sillem mirë me njerëzit, respektoj ndjenjat e tyre</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2	<u>Jam i padurueshëm, nuk mund të qëndroj gjatë në një vend</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3	<u>Kam shumë dhimbje koke, dhimbje barku apo më vjen me vjellë</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4	<u>Zakonisht i ndaj gjërat me të tjerët (ushqimin, lojrat, lapsat etj)</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5	<u>Bëhem shumë nervoz dhe shpesh e humb gjakftohtësinë</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6	<u>Zakonisht rri vetëm, luaj vetëm apo mbyllem në vetvete</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7	<u>Zakonisht bëj si më thonë</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8	<u>Merakosem shumë</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9	<u>Ndihmoj nëse dikush lëndohet, shqetësohet apo ndihet i sëmurë</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10	<u>Vazhdimisht jam nervoz dhe i lëvizshëm</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11	<u>Kam një apo më shumë shokë të ngushtë</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12	<u>Përlahem shumë, mund t’i detyroj të tjerët të bëjnë çfarë dua unë</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13	<u>Shpesh jam i pakënaqur, zemërthyer apo gati për të qarë</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14	<u>Moshatarëve të mi zakonisht i pëlqej</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15	<u>Lehtë hutohem, e kam të vështirë të përqendrohem</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16	<u>Ndihem nervoz në situata të reja, e humbas lehtë vetëbesimin</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17	<u>Sillem mirë me fëmijët më të vegjël</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18	<u>Shpesh më akuzojnë për gënjeshtar dhe mashtrues</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19	<u>Fëmijët dhe të rinjtë e tjerë kapen me mua dhe më ngacmojnë</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20	<u>Shpesh ndihmoj vullnetarisht të tjerët (prindërit, mësuesit, fëmijët)</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

21	<u>Mendohem para se ti bëj gjërat _____</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
22	<u>Marr në shtëpi, shkollë apo diku tjetër gjërat që nuk janë të miat</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
23	<u>Kaloj më mirë me të rriturit se sa me moshatarët e mi</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
24	<u>Frikësohem shumë, trembem lehtë</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
25	<u>E mbaroj (e çoj deri në fund) një punë që e nisi. _____</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
26	<u>Fëmijët e klasës refuzojnë të luajnë me mua.</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
27	<u>Fëmijë e klasës nuk më zgjedhin mua për të luajtur me ta.</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
28	<u>Fëmijët e klasës më shmangen .</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
29	<u>Fëmijët e klasës më përjashtojnë nga aktivitetet e tyre.</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
30	<u>Fëmijët e klasës më injorojnë.</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
31	<u>Shokët dhe shoqet nuk më duan</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
32	<u>Shokët dhe shoqet tallen me mua.</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
33	<u>Do të doja të kisha shume shokë e shoqe.</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
34	<u>Unë jam i shoqërueshëm me të tjerët në moshën time.</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
35	<u>Unë jam gjithmonë duke bërë gjëra me shumë fëmijë</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
36	<u>Unë dëshiroj që shumë njerëz të moshës time të më pëlqejnë mua</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
37	<u>Kam shumë miq</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
38	<u>Më duket e vështirë për të bërë miq.</u>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>